që flasin shqip politikisht mund të jenë një komb, në kuptim të pjesëtarit, të qytetarit, të bartësit të nënshtetësisë të një shteti, të cilët janë të barabartë para ligjit. Këtë interpretim e përruruan francezët. Ata ishin të parët që e krijuan shtetin nacional, pra kombëtar. Mirëpo, ky nocion kishte në thelb konotacionin politik dhe jo etnik. Të gjithë qytetarët e Francës që e kanë nënshtetësinë franceze, trajtoheshin si francezë, pa marrë parasysh etninë, racën, besimin. Ky përcaktim ishte revolucionar për atë kohë, nga që qytetari nuk trajtohej më si pronë e një feudali, konti, princi apo mbretit, por qytetar i lirë që gëzonte të drejtat e njëjta si të gjithë të tjerët. Maksima e kësaj risie revolucionare ishte: **"Egalite, fraternite, liberte"** ("Barazi, vëllazërim, liri"). Te gjermanët situata ishte ndryshe. Ata, të ndarë në feude të ndryshme (në Evropë në shekullin XV kishte afër 500 shtete) e shfrytëzuan përkatësinë etnike, origjinën e njëjtë për ta krijuar shtetin e tyre të përbashkët. Së këndejmi, në Evropë zhvillohen dy procese kombformuese. I pari mbi parimet politike, sipas modelit jakobin francez (të gjithë shtetasit Francës janë francez) dhe i dyti mbi parimet etnike, prejardhjes së njëjtë (koncepti gjerman). Shqiptarët e formojnë identitetin e tyre kombëtar mbi baza të përkatësisë etnike, nga që për ta do të ishte radikalisht e papranueshme që shqiptarët e Maqedonisë të quhen maqedonas, ata të Serbisë serbë dhe ata të Malit të Zi, malazez. Krijimi i identitetit kombëtar mbi baza politike është i huaj për këtë pjesë të Europës, ndonëse ka edhe përjashtime nga ky parim. Bie fjala, në Shqipëri për një periudhë kohore ka funksionuar edhe koncepti politik i kombformimit, kështu që ndodhnin keqkuptime indinjuese, kur ata i quanin shqiptarët e Maqedonisë, "maqedonsa". Po kështu qëndron puna me iden-titetin. Një njeri mund të ketë identitete të ndryshme, si dhe lirinë që ta spikatë një identitet në dëm të tjetrit. Por në nivel shtetëror, në funksion të interesit kombëtar, duhet të spikaten ato vlera që e forcojnë unitetin kombëtar, kohezionin e brendshëm, si bie fjala gjuha, tradita e përbashkët, interpretimi i njëjtë i proceseve dhe personazheve historike, toleranca fetare, inklinimi në sistemin e vlerave evropiane, minimizimi i dallimeve rajonale, adeteve, besimeve etj. Ose dallimet duhet trajtuar si begati dhe jo si faktor për përçarje...

Kajtazi: Ismail Kadare kërkon nga shqiptarët të mendojnë edhe një herë për identitetin e tyre, e në veçanti të mendohen mirë se çfarë identiteti

fetar do të kenë. Shkon aq larg sa kërkon që shqiptarët t'i kthehen origjinës, besimit të vet të krishterë. Çfarë ju mendoni?

A. Xhaferi: Nuk di saktësisht çka ka thënë shkrimtari ynë i madh, prandaj nuk mund ta komentoj qëndrimin e tij. Sa kam dijeni, ai flet me shumë kujdes për këto çështje dhe gjithmonë është shprehur për identitetin evropian të shqiptarëve. Siç dihet, qytetërimi evropian nuk është në përputhje të plotë me një religjion dhe është ndërtuar mbi parimet e laicizmit. Kjo u vërtetua edhe me rastine hartimit të Kushtetutës së UE-së. Mendoj se ky orientim i qytetërimit evropian është modeli shpëtimtar për shqiptarët, formula që në zanafille i eviton fërkimet. Çështja e besimit është, mbase çështja më komplekse, më e ndjeshme në jetën e njeriut. Besimi është mapa orientuese në jetën enjerëzve. Secili mendon se mapa e tij është më e saktë. Mirëpo, këto bindjenuk duhet të politizohen, por të trajtohen si vlerë e intimes së tyre. Besimi buron nga shpirti i njeriut, atë nuk mund ta gjejsh në objekte. Qytetërimi evropian e kultivon këtë qasje dhe në këtë mënyrë i eviton fërkimet fetare. Karakteristikë kryesore e qytetërimit evropian është mendësia inkluzive, pranuese dhe jo përjashtuese. Prandaj, të gjithë marksistë-leninistët dikur dhe gjithë fundamentalistët sot kanë kërkuar strehim në Evropë dhe jo në shtetet komuniste apo në shtete ashtuquajtura islamike. Pas pranimi të konventave ndërkombëtare që garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, apostazia, proselitizmi, konvertimi, kam përshtypjen se janë fenomene të së kaluarës. Natyrisht se këto procese do të vazhdojnë edhe më tutje, në trajta të buta, si e drejtë e patjetërsueshme e njeriut. Konvertimet spektakulare janë të dëmshme dhe gjithmonë kanë shkaktuar efekt të kundërt. Sipas njohurive të mia, edhe Vatikani është kundër konvertimeve pompoze, që për bazë e kanë interesin etjak, apo politik. Për Vatikanin besimi është gjëja më serioze në jetën e njeriut dhe çdo keqpërdorim, instrumentalizim i tij për qëllime jofetare, është i palejueshëm. Në sistemin evropian të vlerave për të gjitha shqetësimet e për dilemat tona, gjenden zgjidhje të pranueshme. Të gjitha besimet monoteiste kanë një substancë teologjike, kanë një burim dhe ofrojnë të njëjtën rrugëdalje për ta gjetur kuptimin e jetës. Problemet nuk shfaqen, pra në planin teologjik, por te shfrytëzimi i religjionit si përçues i vlerave nacionale dhe kulturore të popujve të tjerë, përkatësisht të interesave të tyre të

ngushta. Feja islame ndryshe praktikohet nga turqit, ndryshe nga arabët, apo pakistanezët, afganistanezët, kaukazianët apo iranianët. Detyrimisht ndryshe do të duhej të praktikohesh edhe nga shqiptarët evropianë, pa e lënduar substancën, dogmën që është në funksion të aksiomës në sistemin religjioz. Natyrisht se kundër këtij qëndrimi do të jenë integralistët orientimesh të ndryshme, që përpiqen të imponojnë një unitet që nuk ka ekzistuar as në kohën e profetit Muhamed. Në kohën e globalizmit, ku paralelisht globalizohet e mira dhe e keqja, çdo spektakël konvertues do të krijonte probleme të pazgjidhshme për popullin tonë dhe do të ishte prelud për shthurje mbi baza religjioze. Toleranca fetare nuk është produkt aktual politik, por një vlerë substanciale e traditës sonë, një vlerë që e përcakton identitetin tonë kombëtar. Etnologu serb, Vuk Karaxhiqi sugjeron që serbët, përkatësisht sllavët e jugut, ta kopjojnë modelin shqiptar: "Arnautët... për ne janë më të afërt se gjermanët dhe hungarezët. Ka të tillë që i takojnë ritit roman, diçka edhe ritit grek, por të gjithë quhen arnautë, mund të ndodhë që ata ta urrejnë nga pak njëri-tjetrin, por kundruall të tjerëve sillen si vëllezër, sikur të ishin të njëjtit besim. Ka ndodhur që njëri prej tyre, i besimit turk të vrasë dhjetë turq të vërtetë për një arnaut, cilit do rit krishterë, ashtu si një arnaut i ritit roman të vrasë dhjetë italianë për një arnaut të ritit turk". Ndonëse ky pohim është vulgar, megjithatë e përmenda për të kuptuar se kjo harmoni ndërfetare është e trashëguar dhe nuk është floskulë retorike politike.

Kajtazi: Ku e kanë shtëpinë' shqiptarët, në Orient apo në Oksident? Apo dëshirojnë të mbesin urëlidhës mes këtyre të dyjave, e vetë të mbesin jashtë?

A. Xhaferi: Pa dyshim në Oksident. Shqiptarët nuk kanë forcë, kapacitete, që të luajnë rolin e faktorit ndërlidhës, as që dikush kërkon nga ata ta luajnë këtë rol. Ne gjendemi në Evropë dhe do të ishte fatale për mbijetesën tonë, po që se do të zgjidhnim pozitën skizofrenike. Kur flas për Evropën, e kam parasysh qytetërimin evropian, atë sistem të vlerave që garanton të drejtat njeriut sipas standardeve më të larta, stabilitetin shoqëror, barazinë në shoqëri, mirëqenien e qytetarëve, pa marrë parasysh dallimet.

Kajtazi: Shqipëria është anëtare e Konferencës Islamike? Unë si shqiptar katolik rrëqethem kur më bien ndër mend një gjë e tillë. Them me vete: “Në se shqiptarët e kanë endin në atë konferencë, unë nuk kam dëshirë të jem shqiptar”. A e ka Shqipëria vendin aty?

A. Xhaferi: Pyetje e vështirë. Zakonisht kur duhet të jap vlerësimin për çështje kaq komplekse dhe të ndjeshme, përpiqem të jem sa më racional. Organizata e Konferencës Islamike (Munazzamat al-mu'tamaral-islami) është formuar më 22 shtator 1969 në kryeqytetin e Marokos, Rabat. Selia aktuale gjendet në Xheda, në Arabinë Saudite. Ka 57 anëtare të rregullta dhe pesë me status monitorues, siç është Bosnja dhe Hercegovina (1994), Rusia (2005). Shqipëria u bë anëtare më 1992. Shkas për themelimin e kësaj organizate ishte djegia e xhamisë Al Aksa në Jerusalem, më 21 gusht 1969, nga ana e një ekstremisti protestant nga Australia. Qëllimi i kësaj organizate është përforcimi i solidaritetit mes anëtarëve të saj, përforcimi i bashkëpunimit në të gjitha planet, çrrënjësja e diskriminimit racor dhe i kolonializmit, përforcimi i paqes dhe sigurisë në botë, organizimi për mbrojtje të vendeve të shenjta, mbështetja popullit palestinez, mbështetja të gjithë myslimanëve të botës që luftojnë për ruajtjen e dinjitetit dhe arritjen e pavarësisë, etj. Së pari, në se merret parasysh lufta shteruese dhe tragjike irakoiraniane, lufta qytetare në Liban, në Afganistan, okupimi i Kuvajtit nga Iraku, përdorimi i armëve biologjike kundër kurdëve, bashkëpunimi (solidarizimi) me regjimin e Millosheviqit, hezitimi për njohjen e pavarësisë së Kosovës, pastaj ngufatja e të drejtave dhe lirive të njeriut, pozita e gruas në këto shoqëri etj. Dëshmojnë se kjo organizatë nuk ka kapacitete për ta kryer misionin që ia ka parashtruar vetes. Kjo organizatë nuk është instancë më e lartë, mbishtetërore, me kompetenca vendimmarrëse, që mund t'u imponohen shteteve anëtare, por një lidhje formale, një vend ku rrihet uji në havan. Së dyti, vetë emërtimi i organizatës në vete ngërthen një notë diskriminuese, nga që merr përsipër t'i mbrojë interesat vetëm të një segmenti të njerëzimit, që mund të krijojë probleme shteteve multikonfesionale. Organizatat e ngjashme në botë themelohen mbi parime universale dhe jo segreguese, kështu që nuk ekzistojnë shembuj të ngjashëm të organizatave që mbrojnë interesat e budistëve, të krishterëve apo të racave të ndryshme etj. Së treti, kjo organizatë nuk ka strukturë stabile. Ka shtete që e

suspendojnë anëtarësimin, në varësi nga teket e liderëve të ndryshëm që nuk pajtohen me vendimet që merr kjo organizatë. Bie fjala, Afganistani e suspendoi anëtarësinë prej 1980-1989, Egjipti prej 1979-1984, ndërkaq më 1993 Zanzibari u çregjistrua tërësisht. Së katërti si Shqipëria, ashtu edhe Kosova me kushtetutë janë përkufizuar si shtete laike që do të thotë se nuk mund cilësohen me epitete fetare. Kjo është e qartë, veçmas në se merret parasysh gjeografia. Shqipëria nuk ka forcë për misione të mëdha, kështu që ajo nuk mund të luajë rolin e avokates së Evropës në këtë organizatë dhe as të kësaj në institucionet evropiane. Përfundimisht, kjo organizatë është politike, po të ishte ndryshe atëherë ajo, pa vonuar, do të duhej "en bloc" ta njihte pavarësinë e Kosovës. Kjo, siç dimë nuk ndodhi. Me shumë shtete, anëtare të kësaj organizate dirigjojnë shtete të tjera, Rusia veçmas. Nisur nga këto konstatime, nga keqpërdorimi i fesë për qëllime politike, sidomos në se merret parasysh se vendimet e këtilla mund të nxisin përçarje mbi baza fetare, atëherë bëhet e qartë se duhet të kemi kujdes, që duke rregulluar vetullën të mos e nxjerrim syrin.

Kajtazi: *A duhet të gjithë shqiptarët të jetojnë në një shtet, të flasinnjë gjuhë, të kenë një identitet, të jetojnë nën një flamur, të këndojnë një himn të vetëm? A është kjo dëshirë e pamoralshme e jona, apo s'kemi guxim ta themi këtë?*

Xhaferi: Kosovarët thonë: s'kemi kaçik. Gjatë historisë së njerëzimit është vërtetuar se shtetet nacionale janë më stabile se ato heterogjene, multietnike. Kur këto të fundit hasin në vështirësi, si pasojë e padrejtësive mbi baza etnike, atëherë fillojnë pak nga pak të happen dhe krijohen çështjet etnike. Ky është një proces i pandalshëm historik. Shtetet kombëtare gjithmonë formohen kur shpërbëhen perandoritë, federatat, apo konfederatat. Por, natyrisht se çdo popull që i ka takuar një formacioni të këtillë shoqëror, nuk fiton me automatizëm të drejtën për shtet. Këtë të drejtë fitojnë popuj që kanë vetëdije të lartë kombëtare, zhvillim kulturor, ekonomik, arsimor, teknologjik, marrëdhënie të mira me faktorët relevantë në botë, që kanë një udhëheqësi të aftë për vendime historike. Në rastin shqiptar nuk kemi të bëjmë me dëshirën apo vullnetin që të jetohet në një shtet, por me mënyrën se si të realizohet ky përcaktim. Shqiptarët e mbetur jashtë kufijve kanë vetëdije të lartë kombëtare. Ata më nuk

mund të asimilohen. Sa ata do të kenë probleme me shtetet ku ata jetojnë, aq më shumë këto shtete do të kenë kokëçarje me ta. Mbase me anëtarësimin e këtyre shteteve në UE do të zbuten këto tensione...

Intervistoi P. Ndue KAJTAZI, O.F.M.

BISEDË ME NIKOLLË BERISHAJN**Gjuha shqipe është oazë në mesin e gjuhëve...**

Vitet studentore i kaloi në Lublanë, ku erdhi pas vëllait të madh, i cili ua hapi rrugën disa anëtarëve më të rinj të familjes së numërt shqiptare. Së shpejti u ndërthuren lidhjet e përzemërta të Nikollë Berishajt, i cili jeton dhe punon në Mal të Zi (ai ka përkthyer në gjuhën sllovene veprën Prilli i thyer të nominuesit të disahershëm për çmimin Nobel, Ismail Kadaresë) - me sllovenët. Është autor i Fjalorit sllovenisht-shqip dhe shqip sllovenisht, ndërsa tani në sirtarin e tij krijues pret botimin antologjia e poezisë sllovene, të cilën, në gjuhën e vet do të mund ta lexojnë shqiptarët, ashtu siç mund të lexojnë, falë atij edhe veprën e Kajetan Koviçit, agor Torkarit, Dane Zajcit, Tone Pavčekut dhe letrarëve tjerë sllovenë.

Fillimisht, ju lutëm mos ma merrni për të keq një pyetje personale dhe më tregoni diç për veten. Prej çfarë familjeje jeni, çfarë trashëgimie sollët me vete?

Nganjëherë më duket, sikur biografia ime është shkruar diku para njëqind vjetësh në ndonjë fshat slloven. Familje e numërt dhe e varfër, në të cilën nëna i kryente punët shtëpiake, ndërsa babai punonte punë të rëndë argati në punë të shtetit. E fëmijët si fëmijët, ata gjenden më së miri kur janë shumë. Njëri tjetrin e ndihmojnë por edhe ngatërrohen ndërmjet vetes. Kur u takova si nxënës i shkollës së mesme me tregimet e shkurtra të Ivan Cankarit, nuk e kisha të qartë, se si mund t'i përshkruante një slloven aq bukur familjet, të ngjashme me timen.

Jam, pra, fëmija i shtatë me rend nga nëntë fëmijët e një familjeje punëtore-fshatare të prindërve gjysmanalfabetë. Trashëgimia katolike e familjes shqiptare ishte ndërthurur me tolerancën, pasi që jetonim në një mjedis të përzier fetarisht dhe gjuhësisht. Nëse kësaj i shtoj edhe tentativën e ideologjizimit komunist, me të cilin u takova gjatë shkollimit, pasqyra bëhet edhe më e ndërlikuar. Jo rastësisht flas për mjedisin e përzier gjuhësor e jo kombëtar, ngase disa "shqiptarë" nga

trevë jonë, për shkak të asimilimit (ashtu e quaj tash unë këtë!) shumëvjeçar, e morën shqipen si "gjuhë më pak të vlefshme" dhe e pranuan "gjuhën zyrtare" për të vetën. Në fund të fundit, kjo është karakteristikë e të gjitha trevave në kufirin e dy kulturave. Vërtetë, ky kufi ishte i imponuar në dëm të shqiptarëve, kështu që ne në Malësi (kështu quhet krahina ku jetoj) kemi mbetur pika më veriore e shqiptarizmit.

Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreuva – kuptohet në gjuhën shqipe- në vendlindje, në Tuz (qytezë një 10 kilometra në jug të Titogradit/ sot Podgoricë/ në drejtim të liqenit të Shkodrës). Më vonë Lublana (më 1977 u regjistrua në Fakultetin elektroteknik), vendi i studimeve dhe shumë gjërave tjera të mija, ma hapi një botë të re.

A kanë filluar të ndërthuren lidhjet ndërmjet jush dhe Sllovenisë në ditët studentore, apo ndoshta më herët? Si ndodhi që ndërmjet të gjitha republikave jugosllave e zgjodhët pikërisht vendin tonë, dhe si përkthyes u dashuruan në të?

Lidhjet e mija, më mirë të them lidhjet e familjes sime me Slloveninë filluar të thuren diku në vitin 1970, kur vëllanë tim Gjonin (të tretin me rend), sot aktuar për sigurimet e pasurisë në Entin e sigurimit Trigllav, e zgjodhën si nxënës të gjeneratës në Gjakovë (Kosovë) dhe e fitoi bursën për të studiuar teknologjinë e tekstilit në Lublanë. Ai e kishte më së vështiri, por siç duket edhe bukur, pasi që më vonë na tërhoq njërin pas tjetrit (edhe katër vëllezër dhe motrën) për të studiuar në Slloveni. Sot në Lublanë studion, gjegjësisht i ka përfunduar studimet gjenerata e dytë e Berishajve (Rajmonda, Kristina, Sergeji, Simoni, Ana) me të cilët mburrem shumë si axhë.

Më kujtohen ligjëratat e para në fakultet, kur nuk e dija asnjë fjalë sllovene. Më kujtohet edhe provimi i parë në "sllovenishten" time, të cilën e lavdëroi profesori. "Sikur ta njihja unë gjuhën tënde aq, do të isha tejet i pasur", më tha pasi i kërkoja thellë falje për shkak të sllovenishtes sime të dobët. Më kujtohen edhe kolegët e mi gjithmonë të këndshëm dhe të gatshëm për ndihmë.

Pikërisht ky raport i përzemërt më dha vullnet që ta mësoj sa më mirë të jetë e mundshme gjuhën e këtyre njerëzve. Me kënaqësi të veçantë i kujtohem kujdesit të sllovenëve për pastërtinë e gjuhës dhe kolumnave të Pleqësisë gjuhësore (Jezikovno razsodishçe) në Delo. Në

letërsinë sllovene e njoftova luftën e kombit slloven për një të nesërme më të mirë (çfarë fjalie triviale!) , por edhe guximin që të shprehë atë që për ne në republikat tjera ishte tabu, në veçanti për shqiptarët, dhe në veçanti për shqiptarët jashtë Kosovës.

Së shpejti, rastësisht, duke gërmuar nëpër katalogët e Bibliotekës Universitare dhe Nacionale në Lublanë, zbulova për mua diçka plotësisht të re. U takova me libra dhe artikuj, që i kishin shkruar linguistët sllovenë në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzetë në lidhje me shqiptarët dhe Shqipërinë. Këtë, dikush, me qëllim a jo "na e kishte fsheh" nga plan-programet e gjuhës amtare – shqipes. Për politikën zyrtare të shtetit atëherë të përbashkët kjo nuk ishte e rëndësishme, kjo ishte e vlefshme për harresë. Mbi këtë (pra, mbi kontaktet kulturore shqiptare-sllovene) në vitin 1984 u organizua në programin e tretë të Radio Lublanës një emision me shumë bujë. Redaksia e revistës *Naši ragledi* më luti që ta shkruaj një artikull lidhur me këtë. Artikullin tim *Miklloshiçi ka dijtë, Nachtigalli gjithashtu, po ne?* E lexuan në redaksinë e *Enciklopedisë së Sllovenisë*, që ishte atëbotë në përgatitje e sipër, më lutën për autorizim dhe e botuan në librin e parë të *Enciklopedisë* (A-Ca). Për mua kjo është arritja më e madhe dhe satisfaksioni më i madh.

Si do ta karakterizonit Shqipërinë e sotme? Nëse pyes më saktësisht (mendoj se ne qytete njerëzit jetojnë ngjashëm me qytetet kudo tjetër) – çka mund të na thoni mbi Rrafshin e bjeshkëve shqiptare? Si jetojnë njerëzit e atjeshëm? A mund të thoni vërtetë se »shqiptarët sipas definicionit janë popull asocial dhe kundërkulturore«, siç cek vëllai juaj Martin Berishaj në librin *Fuqia e fshehtë e besës me shtojcën e kanunit të Skënderbeut*?

Do ta thirrsha në ndihmë udhërrëfyesin slloven Niko Niniçin, i cili në Edinost në Trieste (në vitin 1910) e botoi udhërrëfimin ***Albanija in Albanci (Shqipëria dhe shqiptarët)***: »Dhe aty, në truallin e egër arnaut (shqiptar, vër. ime) bëra një gjumë të qetë dhe të ëmbël, që mund të ma falte vetëm bindja se jam nën kulmin e njerëzve të mirë. E këta njerëz të mirë ishin përfaqësuesit e fisit të egër arnaut.« Apo profesorin e njohur serb dr. Vladan Gjorgjeviqin, i cili në librin ***Arbanasi i velike sile (Shqiptarët dhe fuqitë e mëdha)***(Beograd 1923) shkruan: »Arbanasët

(shqiptarët, vër. ime) e kanë bishtin...». E ndoshta edhe shumë ke tjetër do të mund të ceksha.

Me padëshirë bëj përgjithësime, qoftë për të mirë, e më pak për të keq. Popujt, sipas meje, nuk mund të jenë me definicion as të mirë dhe as të këqij, as socialë, as asocialë! Kjo tjetërsi, që thuhet se vërehet ndër shqiptarët, me siguri është pasojë e një historie jo aq të shkurtës, që nuk ishte aq në favorin tonë. Por edhe pasojë e moskuptimit të të tjerëve!

Por, sidoqoftë. Shqiptarët ndër të parët e kanë pranuar krishterimin. Ekzistojnë shënimet se Shën Pali (Letra e Shën Palit në Bibël) gjatë udhëtimit të tij ka ndaluar në Ilirik (besohet se në Durrësin e sotëm) dhe se populli i atjeshëm e pranoi mësimin e tij. Pas 1054, kufiri ndërmjet katolicizmit dhe ortodoksizmit e ndau territorin shqiptar. Shqiptarinë e vulosi edhe okupacioni 500 vjeçar turk, kështu që edhe islami u bë fe kombëtare e jona. Pra, vetëm e dhëna, se shqiptarët u takojmë tri feve dhe jetojnë në tolerancë fetare është argument i mirë për rrëzimin e definicionit që e përmendët. Ndoshta edhe këtë do ta shtoja. Nga gjiri i popullit shqiptar ka dalë Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, që e mbrojtë Evropën e atëhershme nga dyndjet turke, papa Klimenti, Karll Gega (ndër të tjera edhe projektues i hekurudhës jugore kah Triestja!), nënën Terezë dhe shumë të tjerë. Libri ynë i parë, i njohur deri tash, e mban datën 1555, pra është botuar vetëm pesë vjet pa Trubarit...

Nuk jam plotësisht i bindur se dr. Martin Berishaj (vëllau im) në librin e tij *Fuqia e fshehtë e besës* i ka karakterizuar shqiptarët si »asocialë« dhe »kundërkulturore«, por është interesant se sa pak ka lëvizur mendimi i gjeneratës së sotme ndaj shqiptarëve nga qëndrimi i Niko Niniçit ndaj tyre para njëqind vjetësh: *»Është ky popull i shëndoshë dhe i fortë, që nuk ëndërron për të mirat moderne, të cilat gjithmonë kanë për pasojë edhe ligështimin fizik dhe natyror. Është popull burimor, që nuk ëndërron për qëllime të paqarta dhe të mjegullta; që dëshiron ta ruaj të drejtën e vetvendosjes mbi çështjet e veta; që nuk dëshiron të lejojë, që të huajt t'i përzihen nëpunë të tyre...«*

Gjatë leximit të literaturës mbi shqiptarët më ka preokupuar veçanërisht e drejta tradicionale shqiptare, e cila, si mosnjohëse që jam, më ka imponuare dhe çelur pyetje të shumta. A është kombi shqiptar ende aq i lidhur me kanunin, gjakmarrjen, me besën dhe gjëra të

ngjashme, për të cilat mund të lexojmë në librin e vëllait tuaj dhe në veprën e Ismail Kadaresë, Prilli i thyer e edhe tjetërkund? E dimë se kanunet janë trashëgimi shteteve të shumta, edhe në Ballkan – serbët kishin në mesjetë Ligjin e Dushanit -, pikërisht për këtë më intereson se sa vlerë kanë këto për njerëzit e sotëm në Shqipëri? Si e shpjegoni ju Kanunin e Skënderbeut, në ç'mënyrë u flisni fëmijëve tuaj lidhur me këtë, si i pranojnë të rinjtë sot gjërat tradicionale?

Kanuni – është njëfarë kushtetute e Rrafshit (termin i Kadaresë!) së Shqipërisë së Veriut.

Që ta kuptojmë drejt marrëdhënien e shqiptarëve ndaj kanunit, do të na duhej ta shpjegonim mënyrën se si është krijuar ai. Sot i njohim dy versione të kanunit, atë të Lekë Dukagjinit dhe të Skënderbeut. Si Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, ashtu edhe Lekë Dukagjini kanë jetuar në shekullin e 15. Mirëpo, edhe pse e mban emrin e tyre, kjo nuk do të thotë se kanuni është aq i vjetër. Tubimet popullore, gjegjësisht tubimet e parisë së fiseve shqiptare e kanë përcjellë kohën dhe, në mënyrë “konsensuale” i kanë ndryshuar dispozitat e kanunit. Populli që nuk kishte organizim shtetëror dhe që nuk e pranonte mbisundimin e askujt përpos të Zotit, është dashtë ta ketë një mekanizëm mbrojtës kundër anarkisë. Autonominë e fiseve shqiptare i është dashtë ta pranojë edhe vet Perandorisë Osmane, e cila kurrë nuk ka qenë sundues i vërtetë i malësive të Shqipërisë së Veriut. Që nga shteti i Skënderbeut 1443-1468 e deri te Revolucioni Demokratik i Fan Nolit (shteti demokratik që jetoj vetëm gjashtë muaj, më 1924) ne nuk kemi pasur shtet sipas vullnetit të popullit (ta harrojmë për një çast Shqipërinë pas vitit 1990 dhe Kosovën, që është tani duke u bërë shtet). Sundimi turk, okupacioni italian, gjerman e në veçanti Shqipëria e Enver Hoxhës (gjegjësisht të tri Jugosllavitë për një pjesë të kombit) nuk kanë arritur (ndoshta më mirë të thuhet se nuk kanë dashtë të arrijnë!) që me legjislaturën e vet ta prekin thelbin e shpirtit popullor shqiptar. Kanuni ishte tërë kohën alternativë, kishte buruar nga populli dhe ashtu në mënyrën më të mirë e reflektonte vetëdijen kombëtare.

Barazimi i kanunit me gjakmarrjen, gjë që e hasim tepër shpesh në literaturën joshqiptare paraqet (mos)kuptim të thjeshtëzuar të thelbit së kanunit. Ky është shumë më shumë dhe në fakt është kundër gjakmarrjes.

Është interesant se edhe besën – këtë *modus vikendi* të kombit shqiptar, këtë fjalë shqipe e cila nuk përkthehet, të tjerët e marrin shpesh si negative. Para shumë vjetësh në insistim të mikut tim Peter Bozhiçit "mu desh" ta shkruaj një artikull lidhur me këtë.

Pyetja se si t'ua shpjegoj kanunin sot fëmijëve të mijë di të jetë shumë interesante. Sipas meje kjo është e ngjashme me pyetjen si t'ia shpjegoj fëmijës se është shqiptar, ngase kjo është tradita jonë, është trashëgimia nga të parët. Si njeri unë mburrem me faktin që kombi im ka ditë dhe ka gjetur fuqi që nga kujtesa e vet popullore ta bëjë kodifikimin e legjislaturës së vet.

Në ndërdijen e çdo shqiptari ka futur rrënjë mendimi se është më keq të shkelen dispozitat e kanunit, në veçanti ato lidhur me nderin, besën, familjen ... (a nuk janë këto edhe urdhëresat e Zotit!), sesa të shkelet ligji, ngase Ligji ende përjetohet si i "huaj". Kjo assesi nuk do të thotë se ndër shqiptarë nuk ka njerëz që e shkelin kanunin a ligjin, se jemi engjëj pa mëkate. Assesi jo!

Më flisni diçka lidhur me përkthimet e juaja. Jeni anëtar i Shoqërisë së përkthyesve shkencorë dhe teknikë të Sllovenisë dhe të Përkthyesve malazias si dhe përktheni në shqip dhe prej saj prozë, poezi, artikuj shkencorë dhe tjerë. Jeni autor i Fjalorit sllovenisht-shqip dhe shqip – sllovenisht, lexuesve sllovenë ia keni ofruar edhe veprën e Ismail Kadaresë (shkrimtar bashkëkohor shqiptar, që jeton në Francë), romani Prilli i thyer (në sllovenisht e kemi të përkthyer edhe Gjeneralin e ushtrisë së vdekur) i të cilit ngjan në fillim të shekullit të 20. në Rafshin shqiptar, në të cilin janë rrethanat si në mesjetë. Veprën e botoi shtëpia botuese Tuma në bibliotekën Lexo globalisht, dhe është vërtetë një refleksion i bindshëm i marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve, të lidhur me traditën.

Kjo pyetje më kthen përsëri në ditët e para të mija në Slloveni. Në fillim mu desh t'i bëhem përkthyes vetvetes, t'i shënoj të gjitha fjalët e panjohura sllovene. Në insistimin e Zdenko Knezit, i cili edhe më pranoi në Shoqatën e përkthyesve shkencorë dhe teknikë të Sllovenisë, diku në vitin 1980 e përpilova një fjalorth me 1000 fjalët më të shpeshta. Kështu filloi. Në vitin 1989 Cankarjeva zalozhba ma botoi *Fjalorin shqip – sllovenisht dhe sllovenisht – shqip*, i cili u ribotua në Tiranë, në vitin 2002.

Prej letërsisë fillimisht i përktheva nga sllovenishtja disa nga veprat e Igor Torkarit, Kajetan Koviçit, Ivo Svetinës, pastaj Dane Zajcit, Jasha Zlobecit, të cilat i botoja në periodikun shqiptar në Prishtinë e Titograd, e më vonë edhe në Tiranë dhe Shkodër...

Prej poetëve shqiptarë ua kam prezantuar sllovenëve Qerim Ujkanin, Ali Podrimjen, Millosh Gjergj Nikollën- Migjenin, Ismail Kadarenë...

Piki Jakobin e Kajetan Koviçit e botoi Rilindja e Prishtinës, *Gjarprin nën gurë* të Zhelko Kozincit shtëpia botuese Emonica në Lublanë, dhe së fundi, siç u cek, përktheva romanin *Prilli i thyer* të Ismail Kadaresë, të cilin e botoi shtëpia botuese Tuma. Sipas këtij romani në Brazil u xhirua filmi dhe mendoj se vërtetë ia vlen të prezantohet në gjuhë tjera.

Botuesin e pret edhe përkthimi (im) i romanit të tij të dytë *Kush e solli Doruntinën?* Në të cilin Kadare e ngrit besën në nivelin e mitit.

Çfarë gjuhe është shqipja? Si u tingëllon sllovenishtja? Me cilat probleme takoheni më së shpeshti gjatë "operimit" me ato dy gjuhë?

Në trungun e gjuhëve indoevropiane gjuha shqipe zë njërin ndër degët e poshtme. Si gjuhë është oazë ndër të tjerat, pa bërthamë të përbashkët me të tjerat. Sigurisht për këtë shkak ishte interesante për linguistët evropianë në përgjithësi, pra edhe për ata sllovenë. Në bibliotekën time gjendet libri *Rani Andriq (Andriqi i hershëm)*, në të cilin është kopja e indeksit të Andriqit nga Gradci (Austri). Në indeks, si lëndë paraqitet edhe shqipja, të cilën e ligjëron prof. Jireček. Prej sllovenëve me të (me gjuhën shqipe!) janë marrë Kopitari, Miklloshiçi, Çopi, e në veçanti Rajko Nahtigali. Në debatet e tij për shqipen hasim në argumentim shkencor lidhur me gjuhën letrare shqipe, ku si bazë e propozon gjuhën që flitet në Elbasan – në Shqipërinë Qendrore. Përndryshe, deri në fillim të shekullit të 20 shqipja shkruhej me alfabetin latinik, cirilik apo me alfabetin arab, varësisht nga ajo se kush e ka shkruar (kryesisht jashtë territorit shqiptar). Më 1907, në propozim të grupit françeskan, të cilin e ka udhëhequr Gjergj Fishta O.F.M., si alfabet unik shqiptar u pranua alfabeti latinik.

Që nga viti 1972 ne shqiptarët e kemi gjuhën e njësuar letrare, e cila përdoret gjithkund ku janë shqiptarët. Shqiptarët jemi të ndarë në gjashtë shtete: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Greqi dhe Serbi. Interessant, Shqipëria në të gjitha anët është e kufizuar me kombin e

vet - me shqiptarë. Edhe pse mënyra e pranimi të gjuhës letrare kundërmon në politikë (më shumë material gjuhësor është marrë nga dialekti Toskë, prej nga ishte edhe Enver Hoxha, pavarësisht se dialekti i veriut – Gegë i ka dhënë më shumë kulturës shqiptare), gjuha e sotme letrare është element koheziv për krejt kombin.

Për sllovenishten mund të them se për mua është gjuhë tejet e bukur, me siguri edhe për faktin se me këtë gjuhë më lidhin vitet e mija më të bukura. Për të huajt është gjuhë pak e vështirë, posaçërisht dyshësi (*sllovenishtja përpos njëjësit dhe shumësit e ka edhe dyshësin vër. e përkth.*) , mirëpo, me pak angazhim dhe me shumë dashuri sllovenishtja mund të mësohet. Dihet në përgjithësi, se përkthyesi përpos njohjes së të dy gjuhëve, prej të cilës dhe në të cilën përkthen, duhet ta njohë edhe kulturën shpirtërore të të dy popujve. Nganjëherë kjo është vështirësi edhe më e madhe, edhe ndërmjet këtyre dy gjuhëve.

Cilët autorë sllovenë i përktheni në gjuhën shqipe? Si i zgjidhni veprat e tyre, si i zgjidhni letrarët shqiptarë, të cilët i përktheni në gjuhën tonë?

Për mua është përkthimi dashuri e madhe, kështu që vështirë mund të pranoj që të përkthej diçka (mendoj në letërsi), që nuk e vlen, sipas meje, atë dashuri. Zgjidhja e autorëve për përkthim gjithmonë e mban vulën e subjektivitetit. Natyrisht, ekzistojnë disa kritere të suksesit, të pranueshme për shumicën, të cilët e fusin njeriun në një lexim të llojit të posaçëm, mirëpo, për mua, kjo nuk do të thotë gjithmonë edhe "thirrje" e brendshme për përkthim. Për shembull, zgjidhje e poetëve (dhe poezive të tyre) për *Antologjinë e poezisë sllovene* në shqip, e cila momentalisht e zë vetëm memorien e kompjuterit tim dhe të cilën do ta botojë Toena nga Tirana (projektin e subvencionon Ministria e Kulturës së Republikës së Sllovenisë!) ishte pjesa e vështirë e përgatitjes së librit. Shpresoj se kam bërë zgjidhjen, jo vetëm për vete, që në dritën më të bukur do ta paraqesë pulsën e shpirtit slloven.

Qëllimi që ia kam vënë vetes është njohja më e mirë e këtyre dy kombeve. Me përkthime vendoset themel i mirë (nganjëherë edhe jo aq i mirë), por pa to ky themel as që ekziston.

Intervista u botua në revistën Ampak,

intervistoi Natasha Jenush

ATË ANTON HARAPI DHE KRIJIMI I INTELIGENCIES SË RE SHQIPTARE

Arben Ndreca

Dalja në skenë e Rilindjes kombtare në shekullin XIX solli me vete shndrrime të paimagjinueshme politike e shoqnore, ekonomike dhe kulturore. Nji prej këtyne, e që nuk mund të lehet në heshtje, asht krijimi i nji shtrese intelektuale kompakte në vijat e përgjithshme, përta i përkitte pavarësisë së vendit. Mbas gati 400 vjetësh shqiptarët po u orvatshin me u ngritë në kambë edhe nji herë.

Jo rastësisht kur flasim për klasën intelektuale shqiptare të Rilindjes e identifikojmë me atë që mën vonë, në 1912, u ba klasa politike udhëheqëse. Ndryshe nga shumica e vendeve evropiane që jetonin të pavaruna e që drejtoheshin prej parlamenteve apo monarkëve tashma të mbështetun prej nji parlamenti demokratik, në Shqipni sundonte nji klasë udhëheqëse e huej, ajo e pushtuesit osman. Kështu me daljen në skenë të Rilindjes sonë Kombtare si lëvizje çlirimtare e ripërtëritëse e kombit u krijue nji dikotomi e pashmangshme ndërmjet politikës turke, administratës së saj dhe intelligencies së re shqiptare.

Për me e thanë ndryshe, bota e librave të mirëfilltë filloi me hye dalëngadalë e marrshëm në jetën e shqiptarëve e me iu kundërvue botës së defterave, të regjistrave të doganave që nuk shenjojshin gja tjetër veçse numrin e lëkurave të regjuna e të dengjeve të pregatitun për vendet jashtë. Nuk rrodhi pra Rilindja jonë prej nji klase fisnike në vështtrimin gjenealogjik të fjalës, e aq ma pak borgjeze. Të fundit drejtues të vendit ishin zhdukë bashkë me familjet e mëdha qysh në kohën e Kastriotit. Mbas tij nuk kishte mbetë veçse nji vakuum që thekatueshëm ishte zanë prej pushtuesit turk.

Kjo gja bante që intelektualët shqiptarë në gjysmën e dytë të shek XIX të viheshin para disa detyrave me karakter jo vetëm iluminist e përparimtar, por edhe me tipare të theksueme politike. E në fakt shkrimtarët tanë të asaj periudhe njihej si jo vetëm krijues të letërsisë, por edhe të nji vije politike shqiptare, njihen si themelues të ideve të shtetit të pavarun shqiptar.

Të zgjidhun problemi i madh i pavarësisë, inteligjencia jonë u vue përballë detyrave që tashma kishin përgjithësisht karakter ekonomik,

shoqnor e kulturor: një popull të pavarun i duhej sigurue edhe arsyeja se pse me jetue tash e mbrapa i lirë. Duhej justifikue shpallja e pavarësisë me anë të progresit që do të mbrinte shoqnia shqiptare deri atëherë e shtypun jo aq prej taksave të pushtuesit osman sa prej injorancës e mbrapambetjes. Për me realizue këtë duhej që idetë e inteligjencies të përqafoheshin prej popullit mbarë o së paku populli të ndërgjegjësohej për vetë gjendjen e mjerueme e të përpiqej doradorës me u drejtue kah drita e së ardhmes.

Por kur flasim për popullin tonë duhet me pasë parasysh se kemi të bajmë me një popull që duem apo s'duem asht i lashtë — për ata që janë më skeptikë ndoshta duhet me thanë se jemi një popull i përbandë prej shumë shtresave — çka e përjashton mundësinë e homogjenitetit. (Sidoqoftë mungesa e homogjenitetit asht patjetër tipar i popujve të të vjetër. Mjafton me u hjedhë një sy fqinjëve tanë jugorë apo perëndimorë për të cilët nuk ka farë dyshimi se rrjedhin prej antikitetit greko-romak.)

Krijimi i një korpusit të ri inteligjenciet në trungun e një populli shumë të mocëm

Asht ky problemi ma i parë me të cilin ndeshemi te libri i Atë Anton Harapit "Valë mbi Valë". Vepra çelet me përshkrimin e pazarit të Shkodrës në një ditë vere — një laborator psikologjije.

Atë Anton Harapi, emnue famullitar në Grudë për ku edhe asht nisë, mbetet i habitun e në të njajtën mënyrë i mrekulluem prej shumëllojshëmnie së kostumeve popullore, siç thekson edhe ai vetë "edhe brenda krahinës së Shkodrës".

Në vetvete e veçanta e kostumit popullor qëndronte në faktin se asokohe, e ndoshta deri diku edhe sot e kësaj dite, shërbente si letërnjoftimi i personit që e mbante. Prej kostumit dallohej zona e prejardhjes, besimi fetar, mosha e shpesh edhe gjendja civile. Paraqiste pra identitetin e individit, i cili mbrohej në një shoqni që nuk kishte një identitet të përcaktuem mirë e që gjindej gjithnjë nën kërcënimin e faktorëve të jashtëm. Pra, sa kostume e mënyra të veshunit aq edhe ide e koncepte mbi ekzistencën njerëzore. E atëherë mbi ç'baza me krijue një ide të përbashkët intelektuale për përparimin e shoqnisë në të gjitha drejtimet në një shoqni johomogjene e që këtë ide mandej me ia përçue shi kësaj shoqnie?

Për Pater Antonin — siç mund të shihet lehtë prej leximit të librit “Valë mbi Valë” si edhe serisë së konferencave mbajtur në Korçë në vitet ’40 me titullin “Vlerë Shpirtnore” (fq. 80, — asht e kjartë se ajo çka inteligencie e re duhet me përqafue si parim bazë e kriter bashkues drejt përsosjes së idealit të përgjithshëm kombëtar, asht integriteti i pacënueshëm i çdo individ. Problemet, mundimet, vuetjtet janë të ndryshme për çdo person, por subjekti i tyne asht gjithmonë individ, pra edhe zgjidhja e problemeve duhet me u bazue te respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit të çdo individ. Në këtë pikë, — e cila nuk i kundërshton as parimeve fetare e as atyne që mbajnë në kambë shtetin, — duhet të bashkohen të gjithë intelektualët e ri.

Mbrritja e bashkimit të inteligencies

Problemi i varfnisë dhe i domethanijes së jetës janë dy temat kyçe që preken në dialogjet ndërmjet Gasprit e Shanit, dy vëllazën peshkatarë shirokas e Atë Antonit udhëtar te vepra “Valë mbi Valë”. Kah njena anë Gaspri e Shani ndihen jo vetëm të varfën, por edhe të përbuzun prej asaj çka mund të quhej deri atëhere klasa udhëheqëse. Menjherë e gabimisht e identifikojnë Pater Antonin me “zotninë”, me atë që nuk e din se çka janë vuetjtet e tjetrit e që nuk ua kupton hallet, me atë që asht shkëputë përgjithmonë prej jetës së veshtirë që çojnë njerëzit e thjeshtë. Çka të vret ma tepër asht se prej fjalëve të tyne kuptohet sesi i gjykojnë intelektualët, si një kastë me të cilën ata si peshkatarë nuk kanë të bajnë, me një botë e cila mund të vijnë vetëm si udhëtare në lundrën e tyne në shtegtimin e jetës.

“Kobi dhimba, vuetjtet! O përbindsha, qi turrshëm mësyni, e pa farë mëshrire, rrudhni e plandosni tanë ata shka asht e njomë e të kërthnesët në jetën e nierit!” — thotë Pater Antoni. (fq. 70)

Me ngadalë e me durim frati mundohet me ua ba të kjartë dy vëllazënve pikësëpari se çka asht vuetjtja e për çka shërben. Vuetjtet duhet me i shërbye njeriut për me e naltësue kah idealet (fq. 72). Këtë koncept kryesor kristian që i referohet jo vetëm këtyne dy peshkatarëve por mbarë shoqnisë, e që u përket vlerave universale të njerëzimit, Harapi kërkon me ia përcjellë të gjithë inteligencies së re.

Mbas bisedës me të, dy vëllaznit ndihen të përtrimë shpirtnisht. "Faleminders zotnisë që ndejti me ne, na freskoi zemrën." — shprehet Gaspri. Peshkatarët e kanë të kurtë se Pater Antoni nuk ua ka zgjidhë problemet, por se ka dijtë me i dashtë e me u dhanë ngushllim për travaje të jetës tue u thanë se dhimbja nuk asht dobsi sikurse vorfnimi nuk asht poshtnim. E në fakt Pater Antoni u mëson sesi me i përballue dhimbjet me dinjitet. Kjo asht ajo çka populli pret prej inteligencies si klasë e ndritun e drejtuese: me ia njohtë dinjitetin edhe atëherë kur pesha e vujejtjeve asht randue së tepërmi. E prej këtij dinjitetit të njohtun e të pranuem buron mandej edhe respekti e barazia me të gjithë përpara ligjit. Këtu e ka bazën drejtësia shoqnore.

Nji popull duhet të jetë i virtytshëm po të dojë të jetë i lirë
George Washington

Asht fakt i dijtun se klerikët katolikë i ofruen gjithnji popullit shqiptar të njajtat ide e koncepte mbi botën, jetën, zhvillimin njerëzor, progresin mendor e atë ekonomik tue ruejtë kështu koherencën me atë çka besojshin e në të njajtën kohë tue tregue se i kishin të qarta rrugët që duheshin ndjekë për arritjen e synimeve. Tue qenë se shoqnia shqiptare po kalonte nji periudhë të turbullt reformimit e po dilte prej nji epoke që kishte lindë, zhvillue e po vdiste tue lanë mbas vetes nji tymnajë të dendun ku ishte bjerrë orientimi shoqnor, shkolla u ba mjeti numër nji i klerit katolik për transmetimin e këtij morali universal.

Përveç se nji faqe e mrekullueshme letërsije me karakter filozofik, biseda e çiltër me oficerët austriakë në Tuz përban programin për zhvillim intelektual të kombit shqiptar. Gjatë saj rrahen çashtje që intelektualët shqiptarë në përgjithësi do t'u kujtojshin me i shqyrtue vetëm në vitet '30 apo '40.

Pyetjes së profesorit austriak të gjeografisë nëse shqiptarët kanë tekste shkollore të mjaftueshme e gjuhë kombtare të zhvillueme për mbajtjen e shkollave, Atë Antoni i përgjegjet krejt drejt se kanë pasë vullnet e guxim me fillue e mandej vijon: "[...]E sa ma parë të fillojmë me mësue e me bâ që shqyptari t'a mendojë shqyp mendimin e vet, aq mâ shpejt do të mund të gatojmë nierz, mjete e shka lypet për këtë qellim. (fq.106)"

Me mendue shqip nuk don me thanë vetëm me e formulue mendimin shqip por edhe simbas rregullave e normave të mendësisë shqiptare tue shartue në to kulturën evropiane. Don me thanë pikësëpari me i kuptue problemet shqiptare, së dyti me i jetue, e së treti e me u dhanë zgjidhje.

Shkolla shqiptare u pa gjithmonë prej klerit katolik, e veçanërisht në vitet njëzet, si insitucion kryesisht i transmetimit të vlerave, të virtyteve, në bazë të së cilave do t'u filtrojshin mandej edhe ditunitë aq të nevojshme për përparimin e vendit. Në bazë të këtyne kriterëve do të formohej një inteligencie e ndërgjegjshme për rolin e saj historik, një inteligencie që nuk do të kishte frikë me u përballë me sfidat e kohës. Kërkohej pra, prej këtij brezi të ri intelektual që të jepte gjithçka për çashtjen e madhe të përparimit të kombit.

U deshtën pak a shumë 30 vjet që Shqipnia të krijonte një klasë intelektuale, e kjo falë përpjekjeve të shumëanshme si të klerit katolik po ashtu edhe të shtetit shqiptar apo edhe të të huejve që ngritën shumë shkolla.

Sidoqoftë menjherë sa filloi stuhia e Luftës së Dytë Botnore u vunë re dallimet rranjësore ndërmjet grupimeve të intelektualëve. Inteligjencia shqiptare u gjet krejt e përçame përballë situatave të jashtëzakonshme e tepër të ndërlikueme në të cilat gjindej vendi, e sikur kjo të mos mjaftonte, një pjesë e kësaj inteligencie të re të porsakrijume në vend jo vetëm që nuk diji me e udhëheqë vendin, por edhe u ba përgjegjëse për luftën civile që tashma po vijonte pa fre anakand vendit. Shumëkush tue pa sakrificat, trimninë, guximin e pashoq të komunistëve nuk ngurroi me i ndihmue apo edhe me u bashkue me ta. Asokohe jo të gjithë dyshojshin se intelektualët ekstremistë po e shtijshin vendin në një rrugë të pakrye. E këto dyshime u davaritën vetëm me marrjen e pushtetit nga ana tyne, atëherë kur u vue re se ky grup individësh për me zbatue konceptin që ata kishin për barazinë shoqnore nuk ngurroi me zhbi anën e djathtë të barazimit, çka bjen në kundërshtim me parimin ma elementar të matematikës: një barazim kur asht i vërtetë presupozon që të dyja anët e tija të jenë të vërteta, përndryshe asht i rremë. Kështu parimi udhëheqës se të gjithë njerëzit gëzojnë dinjitet të barabartë të cilin inteligjencia e re shqiptare duhet ta kishte pasë si udhërrëfyes, u rrëzue. Inteligjencia e re për me vërtetue se kishte të drejtë sakrifikoi, po, vetveten, por nuk u step kur u ba fjalë me sakrifikue edhe vetë

popullin. Kjo gja vijoi për një gjysmë shekulli kur trashigimtarët e kësaj inteligencie tue u shtye gjithnji e ma thellë sa në një ferrë në një tjetër reformash të pafund dermishën e morën zvarrë mbas vetes edhe krejt popullin tue mos ia kursye vujtjet e pakuptimta në rrugën drejt asaj që quhet humnerë.

Qe pra se dijet e fitueme në shkollë nuk mjaftuene me qeverisë një vend. Çka mungoi qe shpirti e mbi të gjitha koncepti se para vujtjeve të gjithë jemi të barabartë e se dinjiteti i çdo personi asht i shenjtë. Mungoi virtyti për me udhëheqë vendin. Në vend të dashtunisë, urrejtja u ba forca lëvizëse e shoqnisë shqiptare e pasojat e saj i shohim edhe sot.

Fatkeqësisht as vetë komunistët nuk besuen tek ideali i tyre tue mos u ndejtë besnikë as atyne ideve që vetë i kishin zgjedhun lirisht si prijëse në jetë. E vërteton fakti se në Shqipni, — dikur një nga vendet me partitë komuniste ma të forta në botë, — sot nuk kemi sindikata që të mbrojnë puntorët, çka asht detyra numër një e së majtës. Ai grup intelektualësh ishte shkëputë prej popullit për me u ba një kastë e jo një klasë. Inteligencia komuniste u ba sunduese e vendit, por jo udhëheqëse e tij.

Në 1990 komunizmi ra por mënyra e tij e konceptimit të shoqnisë vazhdon me pluskue e sigurtë në llomin shoqnor. Në një shoqni ku individ, pra një person real nuk ka vlerë, nuk ka sesi me pasë vlerë ligji që asht një gja abstrakte anipse i vendosun prej shumicës. E tue mos pasë vlerë ligjet krejt kuptimi i rendit e i rregullit shoqnor bjen poshtë.

Sot, sikurse këtu e njëqind vjet ma parë popullit shqiptar i duhet dhanë një arsye se pse me jetue i lirë e pse me ndërtue një shtet demokratik. Prej intelektualëve duhet justifikue si i drejtë e i dobishëm ai shndërrim i jashtëzakonshëm politik e shoqnor që ndodhi në 1990, sepse kryesori që vujti qe populli e këtë ia kanë me borxh.

E në fund, nuk duhet me harrue se fjala "inteligencie" në vetvedi nuk nënkupton një grup personash që kanë lexue shumë libra, por një klasë njerëzish që besojnë në mënyrë të patrandshme në atë çka kanë nxanë prej librave, një grup individësh të dijtun që, në rasën tonë jo vetëm krijojnë e përcjellin kulturë, por udhëheqin popullin e që pavarësisht se kanë ide e mendime të ndryshme bashkohen në vlerat e përbashkëta njerëzore, në ato vlera që Atë Anton Harapi qortueshëm na i ka lanë trashigim për inteligencien që ka me ardhë.

Bibliografi

1. *Valë mbi valë*, Shpresa & Faik Konica, Prishtinë, 2003
2. *Vlerë shpirtërore*, Shpresa & Faik Konica, Prishtinë, 2003

TOLERANCA FETARE NE VEPREN E ATË ANTON AARAPIT**Nikollë Berishaj**

Diktatura, medoemos fillon me qërimin e hesapeve me kundërshtarët më të "rrezikshëm". Diktatura enveriane, që në fillim i kishte ideatorët kryesorë jashtë shtetit, "zbuloi" armikun ideor e klasor në ata, që deri dje e banin gjallë Shqipërinë. U vranë mizorisht 8 kryepeshkvinj, 4 ipeshkvinj, 53 priftërinj dioqezianë, 25 françeskanë, 10 jezuitë, 10 seminaristë. Ata së bashku kishin bërë 881 vjet burg ose gati 9 shekuj vuajtje. Ata së bashku kishin kryer 450 vjet studime në 24 universitete të ndryshme të Europës. Këtë fat të zi kishte edhe Atë Anton Harapi.

Togfjalëshi që ia dha vulën kryesore veprimtarisë patriotike në trevat arbërore në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, "Atme e fe" u bë sinonim i të gjithë meshtarëve me konopin e ngjeshur të Shën Françeskut të Azisit.

Në familjen time ende sillet një anekdotë nga njëra prej bisedave të shumta që kishte Frati me plakun. Në kureshtjen e tepërt, që duket kishte shprehur plaku për bisedën e Fratit, ky i fundit i kishte thënë: "Prëtashe, këto janë gjana tepër të randa me i kuptua ti.". Plaku i prekur ia ktheu: "Frato, frato, ti di letër e u diç tjetër". Ishte kjo bisedë e autorit me personazhin e ardhshëm të romanit. Bisedë e Atë Anton Harapit me Prëdash Cukën. Dhe vërtet, Frati me diplomë të Universitetit të njohur të Europës tregoi se kishte çka të mësonte nga pleqtë e pashkolluar të Malësisë, aq sa iu dukën aq të rëndësishme për breznitë që vijnë, që botoi vite me radhë (prej 1933-1942) dromca margaritarësh nga filozofia malësore: "Urti e Burrni ndër banorët e Cemit" dhe "Valë mbi valë". Prej të gjitha shkrimeve të Atë Anton Harapit që i lexova (që nga viti i tretë i gjimnazit, kur lexova "Ândrrën e Pretashit", për të cilën, a propo, fitova edhe kritikën e parë nga mësimdhënësi, që kishte marrë përsipër ta ruajë "të kthjelltë" trurin tonë), mu duk për këtë takim më së afërmi tzi marr në vëzhgim dy tekstet të cilat i lexova relativisht vonë, e që më duken se, për fat të keq, jo se e humbin aktualitetin, por për shkaqe reale duhen pranuar si manifest për të gjithë shqiptarët, kudo që gjenden. Shkruante Patër

Anton Harapi në dritën e bishtukut e në qetësinë e Kishës, mendimet më të thella filozofike që dalin vetëm nga lartësia e përulur e mendjes së ngritur. Shpesh punën e tij e ndërprente vizita e paparalajmëruar e malësorit të thjeshtë - burimit të pashterrur të inspirimit të tij. Guximi intelektual i tij e shpie në kacafytje me temën tabu - tolerancën dhe antagonizmat fetarë ndër shqiptarët në përgjithësi, e ndër banorët e Shkodrës në veçanti. Temë kjo, të cilën Frati nuk dëshiron, siç thoth ai "ta mbulojë porsi gacën nën hi".

Kacafytet ai me antagonizmin fetar të ateistëve të ditës, që përkrye natës zënë vendet e para pranë altarit apo në faltoret tjera, çfarëdo qofshin ato. U kundërshton ideve të fanatikëve fetarë, që, na bind me argumente ai, "besojnë vetëm për inate e për shkaqe partiake", por jo me më pak forcë hedh poshtë mendimet e ateistëve, skeptikëve, indiferentëve, aventurierëve e oportunistëve që Shqipëria duhet zhdukur të gjitha besimet, nëse dëshiron të mbijetojë dhe të formojë shtet, ide kjo e mishëruar edhe në vargjet e Vaso Pashës "Feja e shqiptarit është shqiptaria". Hiç më pak nuk i ledhaton as ata që me hipokrizi në veprim, këndojnë këngë patriotike, e as ata që fusin kokën në rërë, si struci, duke thënë se plaga është shëruar, e "dregëza" nuk është më infektuese. Faktin e ekzistimit të tri besimeve ndër shqiptarët mendimtari ynë e merr si realitet të pamohueshëm, në bazë të të cilit duhet jetuar në harmoni vëllazërore. "Pra, për të rrojtë vllaznisht, shkruan Patër Antoni, nuk është nevoja të hjekim besimin, por kusht i parë është të hjekim fanatizmin në besim". Tekstin e parë "Varrë e vjetër - ethe të reja" me karakter polemizues ndaj shkrimeve në revistat e kohës: "Minerva", "Demokratia" dhe "Arbënia", do ta quaja vetëm si hyrje në tekstin tjetër me karakter filozofik - analitik, FANATIZMI - një turp për personin dhe për shoqërinë, që sipas meje paraqet kulmin e mendësisë (ndoshta edhe europiane!) mbi tolerancën fetare në përgjithësi, gjegjësisht ndër shqiptarët, i shprehur me shkrim deri më sot. I futet ai varrës shekullore ndër shqiptarët me guxim të pashoq intelektual, pa menduar se do të keqkuptohet për shkak të veladonit të tij. Me mjeshtri të rrallë e "zhgoglit" deri në atomizimin e saj dhe me akribi të perfeksionuar e shpjegon aq lehtësisht, saqë teksti të jetë plotësisht i kuptueshëm që prej atij malësorit, të cilit i shërbeu, deri te akademiku i rangut të tij. Si njohës i shkëlqyeshëm i shpirtit të shqiptarit, ai vë në pah individualizmin egoistik ("kush nuk mendon si unë, ai është kundërshtari ëm"), si një

ndër shkaqet e (mos)nderimit të bindjeve të të tjerëve, që është pikënisje e tolerancës fetare. Burimin e atij fenomeni të paarsyeshëm, që ai e quan përbindësh, e gjen në "historinë e djeshme dhe trysninë e sotshme". Formulën për mposhtjen e këtij fenomeni e gjen në mbajtjen e sinqertë të parimit "Mos i ban kuj, shka nuk don me ta bâ kush ty". Analizën e zhvillimit të problemit Frati i Grudës e ndanë mjeshtrisht në tri parime:

1. intolerancën dogmatike,
2. tolerancën shoqërore - qytetare, dhe
3. tolerancën shoqërore - politike.

Me përpikëri matematikore e shkathtësi psikologjike ai edhe intolerancën dogmatike (besimet kanë dogmat specifike të vetat, që nuk janë të pranueshme për besimtarët e besimit tjetër) e kapërcen në tolerancë.

"Shpirti i shqiptarit me gjithë besimet e ndryshme e ndien fuqishëm se një i njëjti Zot i vërtetë është Zoti i muhamedanëve, Zoti i ortodoksëve e Zoti i katolikëve", e pra, nëse ne jemi të bijtë e Zotit, vazhdon ai, ne jemi vëllezër, mbetet që si vëllezër të nderojmë reciprokisht bindjet fetare të njëri-tjetrit. Për parimet dogmatike, që do të ishin shkaku më i madh i fërkimeve në mes të pjesëtarëve të besimeve të ndryshme, autori është i bindur se "ato populli as nuk i din, as nuk i merr aq në kujdes; sigurisht as për hatër të Krishtit, as për hatër të Muhamedit". Sa për (in)tolerancën shoqërore, ai përpos spekulimeve të garniturës udhëheqëse, që për ta ruajtur karrigen mbledhin rreth vetes injoranta, trashamana, hipokritë, servila, fanatikë, të cilët i shfrytëzojnë pa mëshirë, ai merr edhe polemikën si formë të intolerancës. Nuk ngurron të përdorë edhe një klasifikim të egër, që shkruar prej penës së tij bëhet më bindës. Natyralizmi i mendimit të tij vret, por duhet respektuar. "Me nivel kulture njerëzore e fetare që kemi, thom se polemika nuk është për ne", thotë ai. Nuk ngurron udhëheqësi i "Hyllit të dritës" tzi sulmojë as bashkëpunëtorët, që në mungesë të kulturës së vet i përdorin faltoret për gjëra që nuk janë të destinuara. "Unë, së mbrami, nuk i ve faj fare muhamedanit apo kristianit pse asht fanatik; ai nëmose asht i sinqertë; fajin e parë pse shqiptari ka mbetë fanatik e

ka hoxha, prifti a popi; këtyne - po nuk patën vetë aq kulturë njerzore edhe fetare, sa me u dalë për vete dhe me u dhanë të tjerëve - u do hjekë e drejta të mësojnë. Por fajin pse fetari e ushtron fanatizmin e ka ai liberali universitar, i cili, me sa mica e qeni, nuk beson as në Krishtin as në Muhamedin, por formon klane për Dinin ase për Fenë e Krishtit, jo pse i intereson Dini a Feja, por pse me atë formë - gjen kush e ndjekë për me qenë ai krye". Thjeshtësia e shkrimit të tij të përvetëson me rrjedhshmërinë, të bind me argumentet dhe të bën ta marrësh si shkrim themelor për të krijuar bindjet tua njerëzore dhe intelektuale. Ai apelon, por apelet e tij kanë forcën e urdhërit të mësuesit të mirëfilltë, si udhëheqës shpirtëror i meshtarëve, pa marrë parasysh konfesionin që i takojnë. Me vetëflijim ai jep shembull se si duhet ruajtur edhe besimtarët e feve tjera, duke marrë kështu rastin e 72000 hebrenjve në Shqipëri e që e futë Shqipërinë, bashkë me Danimarkën, ndër dy shtetet e vetme, ku nuk ka shpërdorim të njerëzve që i takojnë këtij besimi e kombi. Ia njohin madhësinë edhe intelektualë të mirëfilltë si Hafiz Sabri Koçi, kur thotë: "Kam lexuar shumë shkrime, lidhur me tolerancën fetare nga autorë shqiptarë dhe të huaj, por askund nuk kam gjetur një përcaktim aq të saktë e bindës sa ai që jep një shkodran, edhe ai klerik, i pushkatuar nga regjimi komunist, Patër Anton Harapi, i cili thotë se tolerancën e vërtetë e ushqejnë jo njerëzit me besim të përciptë, por ata me besim të qartë e të rrënjosur", apo Mërgim Korça, të dy pjesëtarë të besimit islam. Dhe t'i kthehemi apelit që bëhet urdhër: " E po e patën detyrë besimtarët një herë, kleri shqiptar, muhamedan, ortodoks e katolik, dhjetë herë ma tepër e ka detyrë të shtërngohet dora-doras, e pa vonesë të dalë në lamën e luftimit për tzi a shpëtue shqiptarit besimin në një Zot, shpresën në një Shqipni". Në një bisedë me një meshtar shqiptar mbi atë se cila fe është më e mira, fitova përgjigjen që mund të ishte vetëm pasojë e njohjes së thellë të veprimtarisë së Harapit: "Në maje të Trigllavit çojnë mija rrugë, njëra më e vështirë, tjetra më e lehtë, por ama, të gjitha shkojnë deri në maje. Është çështje jotja cilën do ta zgjedhish", ishte bisedë kjo me botuesin e tanishëm të veprave të Patër Anton Harapin, meshtarin don Nosh Gjollaj.

PRONA – SFIDË E SHTETIT TË KOSOVËS

Valentin Batalaku

Institucionet legjitime të Republikës së Kosovës, tashmë pas pavarësisë ka ardhur koha që të ballafaqohen dhe të angazhohen fuqimisht me çështjen e pronave, e cila ngelet një nga problemet më të medha e më të vështir për tu zgjidhur. A do të zgjidhet çështja e pronësisë në Republikën e Kosovës? Nëse po, kur, e prej kujt?!

Çështja e pronës përgjithësisht nuk zgjidhet lehtë, nëse më parë nuk do të analizohen me përpikëri marrëdhëniet pronësore që kanë mbretëruar disa shekuj në këto anë të Kosovës.

Ajo strukturë juridike që ka mbretëruar në të kaluarën ka lënë gjurmë të thella në koshiençën e popullatës, gjurmë të cilat ndihen edhe sot e kësaj dite, ku tash në kohën kur mungon Ligji për dekonfiskimin, denacionalizimin dhe deksproprijimin, nuk është për tu habitur, nëse edhe qytetarët tanë i frekventojnë zyret e dofarë avokatëve - “shpëtimtarëve të pronave”, agjencive mbi ndërmjetësimin e paluejtshmërive të pa licencuara. Prandaj, ky është shkaku që institucionet qeveritare dhe komisionet parlamentare, para se të miratohen ligjet nga Kuvendi i Kosovës, t'i kushtojnë një vëmendje të posaçme këtyre çështjeve pronësore.

Problemi më i rëndë është fakti, se në Kosovë kur është te çështja e zgjidhjes të kontesteve pronësore-juridike, në këto anë në të kaluarën ka ndodhur një gërshetim dispozitash të rendeve të ndryshme juridike, të cilat në një farë dore edhe kanë koekzistuar, janë përjashtuar nga njëra-tjetra, por edhe janë ndërplotësuar, derisa gati një shekull nuk ka mbizotëruar pushteti serbosllavo-kolonizues. Sot nuk është për tu çuditur, nëse na ofrohen opzione të së drejtës tradicionale, sepse ende te popullata është e ngulitur vetëdija tradicionale juridike.

Natyrisht, se çështja e pronës është çështje madhore dhe të presësh që kjo të zgjidhet sa hap e mbyll sytë është ëndërr me sy hapur. Kjo për arsyen se Republika e Kosovës nuk ka as strukturë ligjore dhe as

buxhetin të tillë që të mund të përmbushi detyrimet ndaj ish pronarëve në ato raste kur prona e tyre në të kaluarën është konfiskuar, nacionalizuar, ekspropriuuar, uzurpuar apo përdorur për shërbime publike si ndërtesat, shkollat, godinat, rrugët etj. Kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe do të gjejë zgjidhje në një periudhë kohe disa vjeçare, kohë kjo që nevojitet për funksionimin e institucioneve komunale dhe qendrore, dhe mbi të gjitha të drejtësisë. Në këtë kontekst, gjykatat dhe autoritetet qeveritare duhet ta luftojnë korrupsionin dhe elementet mafioze kudo që paraqiten, sepse rëndësia e këtij problemi është madhore për rendin e ri juridik që po ndërtohet në Kosovë, se prona private është shtylla kryesore e një shoqërie, prandaj edhe duhet përqëndruar të gjitha potencialet intelektuale në këtë drejtim.

Pra, inovacionet normativo-juridike së pari duhet bërë në planin legjislativ, ekzekutiv dhe atë gjyqësor. Si gjithmonë ai që futet ndërmjet është korrupsioni që nuk i le edhe gjykatësit të jenë të drejtë në vendime. Qoftë me të mirë e qoftë me të keq- për çka edhe po ndodhë në praktikën gjyqësore, se shpesh puna kryhet në anën e atij që ka forcën monetare dhe atë politike. Përkundrajt faktit, se sorollatjet e palëve në gjykata dhe grindjet personale janë shumë të përhapura- kjo është e pa pranueshme dhe e dëmton imazhin e Kosovës përball bashkësisë ndërkombëtare. Pa e zgjidhur çështjen e pronësisë, Kosova nuk ka për të shkuar përpara. Askush nuk investon në një taban të lëvizshëm që nuk dihet se i kujt është. Ajo çka është primare për momentin, se duhet çdo qytetari ti sigurohet barazia për të drejtën e pronësisë, në të kundërtën, problemet do të zgjidhen me vetëgjyqësi.

Përsa i përket pronave në të cilin janë konfiskuar ose nacionalizuar në të kaluarën, autoritetet duhet t'i dëmshpërblejnë ish-pronarët kundrejt vlerës reale komerciale të pronave. Pra, jo duke bërë vlerësime paushale nga komisione të përziara të vendorëve dhe ndërkombëtarëve, por me një kundërvlerë reale dhe strategji transparente dobiprurëse për të gjithë ish-pronarët. Çështjet në lidhje me pronësinë në Kosovë janë shumë të koklavitura. Gjërat duhet shiquar nga një kënd tjetër, e jo ashtu siç jemi mësuar gjer më tani, apo siç na kanë mësuar mentorët tanë në të kaluarën. Duhet të

lirohemi prej koncepteve dhe shabloneve kuturu të ndërkombëtarëve që na servojnë nëpërmjet ekspertëve të tyre, sepse ata nuk i njohin sa duhet veçoritë dhe format e veçanta të pronësisë që kanë mbretëruar në trevat tona.

Prandaj, ekspertët juridik vendor duhet t'i ofrojnë autoriteteve qeveritare skemat juridike, të cilat përmabjnë ato elemente, atribute dhe atë natyrë juridike të cilën vërtet e kanë, me të gjitha veçoritë e ngastrave që ekzistojnë në Kosovë. Këtu në Kosovë mbretëron një mentalitet tjetër në krahasim me ato të shteteve evropërendimore edhe pse synim e kemi t'i arrijmë standrdet e tyre. Të mos harrojmë se niveli i zhvillimit ekonomik të Kosovës duhet ta përcaktojë dinamikën, kualitetin dhe kuantitetin e zgjidhjeve të çështjeve pronsoro-juridike. Skema hap pas hapi është më e përshtatshme se sa eksperimentimi i disa modeleve që na ofrojnë disa "ekspertë" ndërkombëtarë.

Pronësia është një çështje e cila çdoherë gjindet në fokusin e pyetjeve dhe të përpjekjeve për tu përgjigjur. Kështu që edhe autoritetet qeveritare duhet ta përqëndrojnë energjinë e vetë në këtë drejtim. Bashkëkombasit tanë gjithmonë kanë qenë të lidhur me tokën, ku në të kaluarën mjeti kryesor i prodhimit ishte toka. Në aspektin psikologjik toka ishte faktori esencial i familjes, por njëherit ishte edhe forma më e rëndësishme e pronësisë, që ishte edhe pronë e të gjitha gjeneratave.

Siç dihet, në të kaluarën interesi i tërësisë ishte më i rëndësishëm se sa ai individual, kurse tashmë e rëndësishme është prona individuale. Prandaj, në këtë kontekst individët veç e veç duhet t'i grumbullojnë dhe t'i prezentojnë titujt juridik- tapijat si prova për vërtetësinë e pretendimeve të tyre. Sistemi tokësor dhe ai pronësor ka ndryshuar strukturën e vetë, kështu në Kosovë me të madhe paluejtshmëritë kanë filluar të bëhen objekt tregu- i shitjes dhe i blerjes, si të thuhet kanë filluar të bëhen objekte koncentrimi dhe kondicionimi të disa personave të privilegjuar, ku këta po e shfrytëzojnë me dinakëri vakumin juridik në Kosovë. Në këtë vazhdë edhe autoritetet e institucioneve të Kosovës duhet ta përshpejtojnë hartimin dhe miratimin e ligjeve sistemore, me qëllim që të eliminohen këto dukuri të hidhura.

Duhet të jetë e kuptueshme për të gjithë neve, se çështjet pronësore janë të rënda dhe se nuk bën të nxitohet që ato të zgjidhen me anë shablonesh kuazi-juridike, por me një angazhim studioz dhe pragmatik të ekspertëve vendor. Natyrisht, këtu duhet marrë parasysh kushtet dhe veçoritë lokale, historike dhe konfiguracionin e patundshmërive. Shumë është e rëndësishme për autoritetet qeveritare, që gjatë hartimit të projektligjeve, t'iu largohen disa nocioneve dhe përkufizimeve skematike të ish sistemeve juridiko serbo-sllave. Kur janë në pyetje çështjet pronësore projektligjet duhet të hartohen në bazë të analizave të kujdesshme e të thelluara të ekspertëve juridik vendor dhe ato gjithsesi duhet të jenë të kapshme për opinionin e gjerë.

Kosova nuk ka nevojë t'i imitojë superstrukturat juridike të shteteve prëndimore, sepse niveli i zhvillimit ekonomik të Kosovës nuk lejon një gjë të tillë, prandaj duhet t'i hedhim poshtë improvizimet që vijnë nga disa qendra të vendosjes ndërkombëtare. Ekspertët ndërkombëtarët që do të angazhohen në kuadër të misionit EULEX nuk e njohin sa duhet mentalitetin dhe kulturën e popullit të këtyre trevave. Çështjet pronësore apriori me akte të gatshme normative nuk mund të zgjidhen. Prandaj, në këtë drejtim duhet të kyqen edhe gjykatat e rregullta të Kosovës, ku së bashku me gjykatësit e besueshëm dhe ekspertët ti koordinojnë punët dhe vendorët ta japin fjalën e fundit.

Zgjidhjen e çështjeve pronësore duhet elaboruar në aspektin praktik, e jo teorik. Popullata kosovare nuk i kushton edhe aq vëmendje skemave teorike, ajo kontestet pronësore i shikon nga aspekti praktik. Neve nuk na nevojiten formulime teorike të përgjithshme, sepse tashmë jemi ngopur në ish sistemet jugo-serbo-sllave. Kohëve të fundit si po duket është krijuar një përshtypje, se në Kosovë ekziston një konglomerat interesash- çoftë partiake, institucionale, vendore, ndërkombëtare dhe personale. Në këtë vazhdë, po krijohet një atmosferë pasigurie tek njerëzit e zakonshëm, një frustracion: "se çka do të ndodh me pronat e baballarëve të tyre", gjë që ngërthen në vete edhe një inferioritet dhe mosbesueshmëri ndaj institucioneve vendore.

Kohëve të fundit në Kosovë janë duke u paraqitur dukuri shumë të hidhura me rastet e falsifikimit në lidhje me pronat. Rastet e tilla

tashmë i ka konfirmuar edhe udhëheqësi kryesor i Agjencionit Kosovar të Pronës, ku një pjesë e këtyre dokumenteve janë autorizimi për shitjen e pronës, kurse një pjesë e tjetër janë kontrata të shitblerjes së pronës, të lidhura në mes të kinse pronarit dhe blerësit, të cilat një pjesë e dokumenteve janë falsifikuar jashtë Kosovës, kurse një pjesë edhe brenda Kosovës.

Kuvendi i Kosovës kur është në pyetje mbrojtja e paprekshmërisë së pronësisë duhet ta përligj atë në pajtim me përvojat e disa sistemeve perëndimore më të avansuara juridike, por gjithmonë duke përfshirë edhe elementet dhe specifikat e të drejtës zakonore ekzistuese në Kosovë. Në ligjet e reja që do të aprovohen duhet në disa nijansa të përfshihet edhe e drejta zakonore, pra të përkrahen njera prej tjetrës. Me rëndësi është se pronësia duhet të jetë si e drejtë ekskluzive dhe jo ndonjë e drejtë e më të fortit, siç pretendohet nga disa persona të pamoralshëm, ku me manipulime të çfarëdolloji mundohen t'i legalizojnë veprimet e tyre në kundërshtim me dikcionin e ligjeve në fuqi. Pa përjashtim, secilit qytetar duhet t'i sigurohet mundësia, që lirisht ta shpreh ndjenjën lidhur me përkatësinë e paluejtshmërive dhe mundësinë e provimit të bazës juridike të pronësisë para gjykatave të rregullta.

Pra, pronësinë duhet ta konceptojmë si një të drejtë natyrore të pacënueshme dhe të shenjtë, e cila pronarit i jep të drejtën e shfrytëzimit, të përdorimit dhe të disponimit. Prandaj, kjo edhe të gjithëve na obligon juridikisht dhe moralisht, që ta respektojmë këtë të drejtë të njerëzve tjerë. Mirëpo, kjo e drejtë nuk bën të mistifikohet. Natyrisht, përpos që pronari duhet ta ketë pushtetin absolut ndaj patundshmërisë- ky pushtet duhet të lëviz brenda suazave të ligjit në fuqi. Duhet përkujtuar autoritetet qeveritare, se gjatë hartimit të akteve ligjore duhet në mënyrë precize t'i parashohin kufizimet në lidhje me pronësinë. Kufizimet ndaj pronësisë private mund të ndërmerren, vetëm nëse këtë e kërkojnë interesat më të larta të shoqërisë kosovare.

Vetëm në këtë mynyrë zhvillimit ekonomik të Kosovës do t'i japin mundësi edhe këta kategori të qytetarëve, mundësi për të investuar e tregtuar në shume fusha, pasi Kosova është vend strategjik si ne

Ballkan edhe në Evropë. Planet e Evropës së Bashkuar kalojnë nga Kosova dhe është më mirë që qytetarët të përqëndrohen të ardhmes se sa të kaluarës. Pronat të gjithë ish-pronarët mund t'i kërkojnë konform ligjit në fuqi dhe në bazë të atyre që do të aprovohen më vonë, dhe këto të drejta t'i kërkojnë nëpër gjykatat e rregullta. Është nonsens që të heqim dorë nga kërkimi i pronës, por thjeshtë tash është koha që të sensibilizohet kjo çështje, se problemi i pronës është problem i trashëguar që nuk do të gjejë zgjidhje brenda një apo dy viteve, por me dekada. Sidoqoftë, shumkush pajtohet me thënjen: »se pitja është ngrënë, por tepsija ka mbetë«, për çka edhe ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre iu mbetet të besojnë në angazhimin dhe seriozitetin e institucioneve të Republikë së Kosovës.

Shqiptarët qysh moti e kanë kuptuar, se prona është njëri nga synimet më të larta të qenjes njerëzore, e cila e përfaqëson edhe shkallën më të lartë të lirisë njerëzore, sepse në vetëvete përmban edhe lirinë e njeriut.

Prandaj, me të drejtë edhe qytetarët e Kosovës, pa dallim kombësie dhe feje presin nga Kuvendi i Kosovës që të ofrojë të gjithë infrastrukturën ligjore për veprimin e EULEX-it, e cila do të jetë e shtrirë në tërë teritorrin e Kosovës. Ndërsa Shefi i misionit të BE-së në Kosovë EULEX, Iv de Kermbon të ketë rolin këshilldhënës, monitorues dhe udhëzues, duke sjellur ekspertë nga fusha e gjyqësisë, policisë, doganat etj. Ka kaluar koha kur normat juridike kumbonin si fraza boshe. Kosovës nuk i nevojiten improvizimet.

MJERIMI I MENDIMIT POLITIK**Afrim Kasolli**

Fundamenetalisht politika kosovare vazhdon të jetë një politikë jomendore, (jo në kuptimin se aktorët relevant të saj nuk mendojnë fare, por në kuptimin e prodhimit të atij mendimi i cili e paraqet humusin e përgjithshëm teorik mbi të cilën mbëltohen idetë themelore të veprimit politik). Kurse këto ide më pastaj i përbëjnë parimet e udhërrëfimit praktik, në bazë të të cilave orientohet dhe strukturohet një shoqëri e caktuar në kohë dhe hapësirë për t'i realizuar qëllimet e saj kryesore. Pra këtu është fjala për atë lloj të ideve me anën e të cilave bëhet artikulimi mendor si dhe paraqitja diskursive e esencës historike dhe politike të një realiteti konkret social dhe politik brenda të cilit jetojmë dhe veprojmë. Në anën tjetër, ky raport i ndërsjellë ndërmjet ideve dhe realitet, paraqet boshtin qenësor për sajimin e substancës ideologjike, të formacioneve politike të cilat operojnë brenda një hapësire të caktuar politike. Kështu partitë politike si entitete organizative të cilat e synojnë marrjen e pushtetit në saj të luftës politike, me synim realizmin e programeve të tyre, e ndërtojnë aktivitetin dhe identitetin e tyre pikërisht mbi premisa ideologjike. Në këtë mënyrë, ato e synojnë po ashtu edhe prodhimin si dhe implementimin e disa vlerave fundamentale politike dhe etike.

Në këtë kontekst, as që mund të flitet për "fundin e ideologjive", ashtu siç propagandon sot plotë bujë klasa politike kosovare. Por, këtu më tepër mund të flitet për nënshtrimin e kësaj klase politike, pa ndonjë sens kritik, ndaj asaj paradigme ideologjike që e proklamon dhe shpall "fundin e ideologjive. Sigurisht se një logjikë e tillë ka për qëllim privimin e formacioneve të spektrit politik kosovar nga mjetet e tyre të prodhimit ideologjik dhe shndërrimin e tyre vetëm në administruese teknike të ideologjisë dominante aktuale.

Natyrisht, këtu me konceptin e ideologjisë nuk duhet nënkuptuar atë model i cili dikur në saj të mitit madhor synonte transformimin rrënjësor të botës me anë të revolucionit politik dhe shoqëror - si

veprim total ku energjitë e përgjithshme përqendrohen në shkatërrimin e rendit të vjetër dhe vërshimin e vrullshëm të një bote të re, por me këtë rast me nocionin e ideologjisë nënkuptojmë atë model të organizimit politik, ku ideologjia ka rëndësi themelore në përkufizimin e interesave afatgjata politike, madje duke përcaktuar edhe identitetin e pjesëmarrësve brenda një entiteti politik, si dhe duke arritur që “interesin e qytetarit ta transformojë përmes përfaqësimit nga një tog interesash konkrete, në një interes abstrakt dhe kolektiv”. Pra kaq e mpleksur është ideologjia me politikën, sa që është e pamundur që të bëhet një ndarje ndërmjet tyre. Duke u shprehur në mënyrë metaforike mund të themi se ideologjia e paraqet kokën e një organizmi, kurse politika praktike, parqet trupin e tij. Kështu pretendimi për të zhvilluar një veprimtari duke mohuar tjetrën është një lloj sikur pretendimi se mund të mbash gjallë një organizëm duke e ndarë trupin nga koka e tij.

Sidoqoftë, si pjesa më interesante e krejt këtij rrëfimi, pa mëdyshje se mbetet vet mënyra se si është plazmuar ky vizion i sipërcekur. Është më se e qartë për të gjithë ata që merren më studime teorike pak më kritike – në dallim prej interpretimeve të publicistikës ditore - se nocionet dhe konceptet themelore që dominojnë në një shoqëri të caktuar pa dyshim se janë shprehje e raportit të forcave reale politike dhe shoqërore që dominojnë në atë moment historik dhe politik. Tek e fundit, a nuk ishte K. Marksi ai i cili na ka mësuar se prapa çdo forme të ideologjisë maskohen interesa konkrete politike dhe ekonomike? Kurse mendimet sunduese të një grupi nuk paraqesin asgjë tjetër pos mendimet e sundimit të tij, me të vetmin qëllim që të ruhet qenia politike e atyre që sundojnë mbi pjesët e tjera të shoqërisë – duke i detyruar kështu ata të cilët janë të nënshtruar që t’i përvetësojnë kategoritë dominante të sistemit në trajtën e dogmave dhe pa ndonjë sens kritik. Me një fjalë, që të arrihet nënshtrimi mendor dhe shpirtëror i tyre. Prandaj një zhbirim më substancial i relacioneve konkrete ndërmjet sferës së “pushtetit me atë dijës”, në saj të teknikave të “arkeologjisë politike” do të na e bëjë të mundur që ta shohim edhe gjenealogjinë e këtyre nocioneve themelore. Në këtë kontekst mund të vihet në pah se sistemi i ideve aktuale apo ky konglomerat ideologjik, është prodhuar drejtpërdrejt nga sistemi sundues i pushtetit politik dhe si i tillë ai më tepër i përfaqëson dhe

mbron interesat e tij, se sa ato që gjëllojnë në të vërtetë në nivelin horizontal të shoqërisë kosovare.

E mënyra e etablimit të këtij rendi të ri është bërë tejet qetësisht, e pa efekte spektakolare nga administrata ndërkombëtare, duke kontrolluar mediat, duke izoluar oponencën kritike ndaj sistemit si dhe duke e tjetërsuar rolin e të vetëquajturave parti politike kosovare, vetëm në mekanizma të thjesht teknokratik të administrimit postpolitik. Ndërkohë imponimi i këtij rendi "postmodern", ku politika kosovare i është nënshtruar hegjemonisë aktuale konceptuale me të vetmin qëllim administrimin e saj, në mënyrë eklatante spikat po ashtu edhe brenda diskursit zyrtar të kësaj politike. Një shtjellim eksplicit i këtij ligjërimi e nxjerr në pah mjerimin mendor të kësaj politike, si dhe sterilitetin e aparatit diskursiv të saj. Lidhur me këtë rast është interesant të konstatohet edhe shkëputja totale që ekziston tashmë këtu e sa kohe më parë ndërmjet këtij diskursi si dhe gjendjes reale politike dhe shoqërore që aktualisht dominon në Kosovë. Duke i dëgjuar me vëmendje prononcimet e përfaqësuesve të klasës politike kosovare të krijohet përshtypja sikur në Kosovë tashme paska triumfuar përfundimisht "paqja e parajsës post-historike", sepse Kosova qenka një nga vendet me të sigurtat në rajon, të gjitha dilemat qenësore qenkan zgjidhur brenda këtij sistemi politik, kurse evolucioni ideologjik më në fund ka arritur majën e vet kulmore dhe se ky rend paraqet "fundin e historisë", struktura e të cilit as që ja vlen fare të problematizohet në aspektin mendor, por qëllimi themelor mbetet vetëm që të administrohet në mënyrë sa më të mirë të mundshme.

Përgjithësisht në koherencë me këtë qëndrim, protagonistët kryesor të kësaj klase politike me anë të një përceptësie llomotitëse, operojnë me nocionet tashmë të njohura si ato të demokracisë, ekonomisë së tregut, shoqërisë multietnike e multikulutore, integriteteve evropiane e transatlantike, madje duke mos lënë anash as nocionin tashmë më të stërpërdorur në shkencat sociale, atë të globalizmit. Në të vërtetë këtu nuk mund të mohohet fakti se është fjala për nocione të cilat padyshim se sot paraqesin kuadrin e ideve të pranuar në një nivel më të gjerë, por çështja është se si të tilla ato ide megjithë pranimin thuajse universal në vetvete "janë një enë zbrazët e cila duhet të mbushet me përmbajtje konkrete". Pra këto sisteme në esencë paraqesin vetëm kornizën abstrakte në kuadër të të cilave

strukturohet realiteti konkret politik dhe shoqëror. Kurse modelimi i këtij procesi përbën anën tjetër të këtij fenomeni tejet kompleks i cili është i varur në masë të madhe edhe nga natyra e problemeve lokale që dominojnë në një shoqëri. Prandaj është pikërisht mënyra se si është duke u dizajnuar përmbajtja e sistemit aktual politik në Kosovë, ajo e cila ka nevojë që të shestohet më së shumti për momentin. Paradoksalisht, kjo klasë politike, gjatë gjithë kohës është duke mbrojtur vetëm aspektet teknike dhe abstrakte të këtij procesi por duke injoruar dhe mospërfaqësuar çështjet përmbajtësore të tij. Kurse kjo dihotomi ndërmjet përmbajtjes dhe formës, mendimit dhe veprimit, për pasojë ka bërë që politika kosovare të mbetet një politikë së cilës i mungon totalisht një substancë mendore, të mos jetë në gjendje që ta artikulojë në nivel diskursiv esencën e nevojave fundamentale të kësaj shoqërie, si dhe të kolonizohet tejet ekstremisht, në nivelin konceptual nga forcat e sotme dominante. Ndërkaq mungesa e shtjellimeve të mirëfillta konceptuale, ka bërë që problemet kryesore që shprehen në diskursin e kësaj politike në formën tashmë të njohur të një performance ritualistike, të mos jenë probleme që pulsojnë nga nevojat e kësaj shoqërie, por ato të jenë të definuara dhe imponuara nga instancat tjera vertikale të shoqërisë të cilat monitorjnë dhe kontrollojnë proceset aktuale. Për rrjedhojë kjo politikë është tjetërsuar në të gjitha aspektet e saj qenësore, por që si e tillë majën e vet kulmore të këtij perversiteti e ka arritur pikërisht me fenomenin e zëvendësimit në mënyrë shumë subtile dhe të pahetueshme të “veprimit të lirë politik me atë të sundimit”.

Gjithsesi si një ndër aspektet e tjera negative të aplikimit të kësaj paradigme të sipërcekur mund të veçohet po ashtu edhe mungesa e debateve të mirëfillta politike dhe ideologjike, duke bërë që përfaqësuesit e politikës kosovare të bien pre e një retorike demagogjike e cila nuk shpreh asgjë konkrete dhe përmbajtësore. Prandaj kjo edhe është arsyeja kryesore se pse lidërshipi politik i vendit është bërë gjithnjë e më identik me diskursin e tij, duke përdorur të njëjtat fraza politike, por, me të vetmin ndryshim, në mënyrën se si i qepin fjalët në kuadër të fjalisë gjatë sajimit të prozës së tyre dhe frazave bajete politike. Kështu mjafton që të hapet një temë e caktuar nga kancelaritë e diplomacisë perëndimore dhe atëherë të gjithë përfaqësuesit e strukturave politike institucionale, po

sa ta dëgjojnë sinjalin e saj, në stilin e burokratëve tipik, menjëherë zhyten në një rivalitet tejet servil dhe shumë të pakuptim se cili është më shumë pro kësaj teme – pavarësisht faktit se tema të tilla shpesh herë mund të jenë edhe në kolezion me interesat e përgjithshme të kësaj shoqërie. Një dukuri kjo e cila tashmë është duke spikatur me mënyrën e miratimit tejet të turpshëm të “ligjeve ahtisariane”, - miratim ky i cili është duke u bërë pa asnjë një lloj shestimi paraparak në lidhje me vlerën si dhe efikasitetin e tyre administrativo – juridik, në kuadër të këtij konteksti politik.

Sidoqoftë deficitet e tilla ideologjike që sot e karakterizojnë politikën kosovare i bëjnë po ashtu irelavante edhe distinktimet nominale ndërmjet formacioneve grupore që ekzistojnë brenda këtij spektri politik. Nuk mund të ketë kompeticion të mirëfilltë politik aty ku ky aktivitet nuk zhvillohet në nivelin e ideve. Prandaj veprimtaria politike dhe hapësira e diskutimeve publike sot është uzurpuar nga një ndeshje gjelash vetëm për efekte mediatike, duke e shndërruar këtë sferë në një spektakël tipik ku në të njëjtën kohë i bënë qytetarët “spektatorët dhe humbësit më të mëdhenj të saj”. Kurse kjo mënyrë e ndërtimit të operimit politik mbi negacionin e premisave mendore, përbën ndoshta sot edhe arsyen kryesore që ligjërimi politik i përfaqësuesve më të lartë institucional të Kosovës “multietnike e demokratike”, të mos jetë asgjë tjetër pos një reproduktim i dobët i reklamave televizive që në vazhdimësi janë emituar nga masmediat vendore elektronike, e të sponsoruara nga ofiçina ideologjike e administratës ndërkombëtare. Në këtë mënyrë fillimisht është bërë plazmimi i strukturave politike në koherencë me këtë ideologji, e të cilat më pastaj kanë marrë rolin që ta transmetojnë edhe në nivele të tjera të shoqërisë. Prandaj nuk është e rastësishme se pse qytetarët e Kosovës vazhdojnë të bombardohen çdo ditë nga një llafollogji e përgjithshme prej përfaqësuesve të tyre, në lidhje me shoqërinë “multietnike e multikulturore”, pavarësisht faktit se kjo shoqëri në përmbajtje vazhdon të jetë e pa punë, e varfër dhe poshtëruar nga skamja dhe mjerimi, e papërfaqësuar denjësisht në kuadër të mekanizmave politik e institucional të demokracisë, pa ndjenën bazike të sigurisë, si dhe pa perspektivë të qartë politike e ekonomike.

Sidoqoftë, ky dështim i përgjithshëm i politikës kosovare, për të artikuluar esencën e nevojave reale të shoqërisë kosovare, mund të perceptohet po ashtu edhe si pasojë e kolapsit total të shtresës intelektuale në kuadër të kësaj shoqërie. Është pikërisht kjo shtresë ajo e cila ma anë të veprimtarisë së saj epistemike dhe aktivitetit reflektiv arrin që t'i artikulojë parimet e përgjithshme të një shoqërie në trajtën e konstruksioneve ideale – duke bërë që më pastaj këto gjedhe ideore të shërbejnë edhe si pika referimi dhe orientimi për veprimtarinë etiko-politike. Këtu edhe qëndron arsyeja kryesore se pse mendimi dhe veprimtaria praktike politike ndodhen në relacione të pashkoqura njëra me tjetrën madje duke përbërë vetëm dy anë të së njëjtës medalje (e jo në marrëdhënie antinomike siç supozohet nga klisjetë e zakonshme). Kjo tregon se një politikë e mirëfilltë duhet që çdo herë të ndërtohet mbi premisa të qëndrueshme diskursive. Kurse çdo mendim politik ka për detyrë që në mënyrë qenësore ta shpreh dhe kondensojë esencën e nevojave reale të një shoqërie, duke e kanalizuar në formë institucionale në trajtën e interesit universal. Por, në dallim nga ky funksion që ka dhe luan shtresa intelektuale në shoqëri, përkundrazi, tek ne, një pjesë bukur e mirë e kësaj kategorie shoqërore, është strukur nën çatinë e disa institucioneve pseudoshkencore, pjesa tjetër ka demonstruar një tundim të madh drejt lartësive të olimpit politik, si dhe duke gjakuar pushtetin me shumë se çdo vlerë tjetër, me të vetmin synim që të gjejë strehë nën ombrellën e tij. Kurse ngarendja e kësaj kategorie drejt pushtetit është zhvilluar në një mënyrë politikisht tejet degraduese, profesionalisht diskredituese, si dhe moralisht degjeneruese. Kjo shtresë pra në vend se ta tërheq klasën e politikanëve drejt ideve të tyre intelektuale, për fat të keq ka bërë të kundërtën, ku intelektualët me idetë e tyre gjatë rekomandimeve politike me një servilitet tejet ekstrem, i janë nënshtruar dhe përshtatur kriterëve të pushtetarëve. Frymë kjo e cila e ka minuar prodhimin e mendimit politik edhe në këtë segment, sepse më tepër se sa me një angazhim parimor të intelektualëve, këtu në të vërtetë më shumë kemi të bëjnë me shfrytëzimin e tyre, për qëllim justifikimin e interesave ditore të grupeve dominante politike.

Është pikërisht kjo mënyrë e veprimit, ajo e cila e shndërron intelektualin në “shërbëtor të nënshtruar të pushtetit, në përsosës të artit të skllavit, e të gënjeshtres” (F.Lubonja) - dukuri këto të cilat edhe

paraqesin mëkatën më të rëndë intelektual si dhe "tradhtinë" më të lartë morale ndaj së vërtetës. Kështu, shtegdalja nga ky mjerim i përgjithshëm mendor, si në sferën politike, kulturore, ideologjike apo shkencore në të cilin jemi katandisur tash e sa kohë, nënkupton edhe ndryshimin e këtij raporti, për ta mundur edhe atë që Michel Foucault, e quan "armiku madhor", "kundërshtari strategjik" - fashizmi që është tek të gjithë ne, që s'i shqitet mendjes dhe sjelljeve tona të përditshme. Fashizmi që na bënë ta duam pushtetin, që na bënë që edhe vetë ne të gjakojmë, për atë që na dominon dhe shfrytëzon".

Prandaj, për fund, mund të themi se ka ardhur koha për krijimin e një politike, e cila dallon rrënjësisht nga konditat e deritanishme të operimit politik. Në substancë, kjo politikë e re, - përkundër funksioneve vetëm tekniko administrative që ka tani - duhet të jetë në gjendje që aktivitetin e saj ta ndërtojë kryesisht edhe mbi premisa të qëndrueshme teorike dhe mendore. Ndërkaq, ky mendim, në vend se të mbroj interesat e grupeve dominante politike, duhet që të jetë i implikuar drejtpërdrejt me praktikën konkrete shoqërore, me qëllim që ta bëjë sublimimin si dhe artikulin sa më të denjë të saj - kombinim ky i domosdoshëm edhe për realizimin e një emancipimi të përgjithshëm shoqëror. Vetëm mbi këtë ndarje radikale nga politika aktuale mund të krijohen kushtet për përkthimin interesave fundamentale të kësaj shoqërie në gjuhë juridiko-politike, si dhe të bëhet implementimi i tyre në mënyrë institucionale.

SHTRIRJA E ËNDRRËS SË BEKTASHIZMIT NË SHQIPTARIZËM

Gezim Llojdia

Pak përpara se Tirana të bëhej, kryestrehë botërore e tarikatit bektashi ka një fakt të vërtetuar se shqiptarët ishin nga popuj, që e përthithën, qysh në ardhje, ngase bektashizmi u ngjasonte zakoneve shqiptare. Ndërkaq cila është afria e tyre? Shqiptari i urtë i rritur afër maleve është detyruar shpesh të kërkojë të fshehtëni qiellore, por në mënyrën e vet pagane. Duke qenë se është afruar, por duke mos e arritur dot, besonte në besëtytni të rreme. Kishte pyetur veten, jo rrallëherë: thua vallë nën këtë heshtje yjesh, vishen pemët në mërmërimën pranverore. Kush e ka" vulën, " "dekretin", kush e nënshkruan, për të filluar njëkohësisht gjëmimi pranveror? Nën cipën e hënës, ndriçimi i gjallë i yjeve, shugatej duke të ndjellur ëndërrime. Nga torba e Kristoforidhit: Vështroni o shok vështroni se si qenka mbuluar majë e malit të Tomorrit me mjegullë e re. Shih, shih si shkrep mali xixa xixa e nxjerr shkëndija t' arta e të argjenda. . .

Naimi këndonte: "Tomor! O mal i bekuar, fron i lartë, që rri Zoti-Pasë fesë së vjetër, që kishin shqiptarët qëmoti. . ."

Mirëpo ka qënë një farë Haxhi Babai, aty nga viti 1600, që solli një grusht dhe nga Qerbelaja për kultin e Cukës së Tomorrit.

Në të vërtetë udhëheqësi i bektashinjve erdhi, që prapa këtyre bregoreve nga dervishët e Haxhi Bektashit duke derdhur aty, dritën e argjendë.

Nën qarkun e kësaj botë misterioze u ndriçuan shumë shpirtra, që në muzg notonin. Urdhri i bektashizmit, i gjeti tokat e shqiptareve, pak përpara ardhjes së perandorisë osmane. Në kujtime të E. bej. Vlorës, cilësohen ardhja e urdhrave përpara këmbës së ushtarit perandorak osman. Dielli i bektashizmit fluor lëshonte mbi këto vise refleksione trendafili të rrezeve të tij, ai u pasqyrua në mijëra herë në shpirtëra të ngurosur, që s'kishte të sosur, plot gaz e gjallëri. Por dokumenti faktik mbetet i patjetërsueshëm. Vetëkqyrim dëshmi, fakte, shifra. Pati një korelacion aritmetik. Bektashizmi kjo dritë e prurë nga dervishët e Haxhi Bektashit për shpirtëra të urit, që lëshonte rreze dhe njerëzit gjithsesi u pikonte në shpirt. Dëshmitare, mbeten të dhënat e kohës.

Fundi i shekullit XIV e gjeti Shqiperine me 100 mijë bektashinjë. Në 1934 Parlamentit shqiptar ju paraqit propozimi, që fe zyrtare e shtetit të njihej bektashizmi.

Në 1936, kohë monarkie ishin 250 mijë bektashinj ose 25% e shqiptarëve. Eshtë ora, kur nga trysnite e kohës u krijua diamanti i besimit tek shqiptaret, sidomos në zonat e mesme dhe jugore të vendit. Hyrja e stuhishme e bekatshizmit tek shqiptaret, pasqyrohet me fakte domethënës. M. Tirta sjell: në regjistrimin e vitit '45 emri, mbiemri Ali në 6614 persona. Emri ose mbiemri Abaz Aliu ose Abas 1416 persona. Mbiemri ose emri Bektash 590 persona. Dervish, emër, ose mbiemër 4390 persona. Hysen 8007 raste. Hasan 6675 raste.

Kurse nga vitet 1878-1912 nga kohë rilindje deri në pavarësi u shtuan në këto vise 50 teqe të reja.

Dervishë dhe teqe në përndritjen kombëtare

Këto faltore ishin ndërtesa fetare të quajtura teqe, hynë vrullshëm duke ndikuar në çështjen shqiptare.

Një hartë me shtrirje hapësirash bektashiane në viset shqiptare.

Një zonë :Krujë, Elbasan, Cermenikë, Peqinë.

Zona e dytë :Berat, Skrapar, Tomorricë, Përmet, Leskovik.

Zona e tretë :Vlora, Mallakastër, Tepelenë, Gjirokastër, Delvinë.

Një zonë të katërt :Tropoj, Kukës, Prizëren, Gjakovë, Dukagjinë, Mitrovicë, Shkup, Tetovë.

Frymëmarrje kombëtare e teqeve:

Teqe, që hynë në përndritjen kombëtare me kontributin shqiptar. Teqe e Frashërit, Backë, Prishtë, Melçanë, Qatrom, Fushë-Krujë, Gllavë, Shëmbërdhenj, Turhan, Gjirokastër.

Kryeteqeja

Kryeteqeja e Frashërit në malësi të Dangëllisë. Baba Alush Frashëri i biri i Dalib Frashërit ndjeu shkelqimin, që afronin burrat e shquar të trevës jugore, ditën që hynë në mejdan. Kjo teqe në Frashër, një moment të jetës së saj do të rilindte, duke pritur ditën kur krerët aty do të krijonin, lidhjen e vogël të Prizerenit. Përfaqësuesit ishin nga këto krahina Janinë, Berat, Margëlliç, Ajdunafi, Gjirokastër,

Përmet, Vlorë, Pragë, Artë, Prevezë, Tepelenë, Kolonjë, Korçë Teqet e tjera me dervishet e urtë hapen mejdanet dhe shpirtin, për t'i ndihur fatit, duke larguar fatin e keq, që u vardisej shqiptarëve.

Zëri i shqiptarizmës

Një farë Dervish Bektash, aty nga 1852 në teqe të fushë Krujës, propagandë kombëtare. Baba Ramadan Qatromi me Sali Butkën mblodhën 800 trupa për të mbrojtur Korçën, nga hyrja e grekërve pas largimit të francezëve. Baba Zenel Kaloshi me Abdi Toptanin pjesmarrës në vulosjen definitive për ngritje krye kundër perandorisë në zonat e Krujës. Baba Hajdar Turhani kapet dhe burgoset. Baba Haxhi Kruja për përhapje të librit shqip e internuan. Baba Medin Gllava "Besë dhe bashkim për shpëtimin e atdheut. Motivacion nga Qeveria e princ Vedit. Baba Hysen Melçani zbret deri në Vlorë në pavarësinë e vendit.

In memorial shqiptarizmi për dervishët rilindas.

Baba Hysen Melçani, Hysen Kukeli, Abedin Frashëri, Haxhi Hysejn, Dervish Ali Dedej, babai i teqes Harabati Tetovë, Baba Xhaferi i teqe së Prishtë, Baba Fetahi i teqes së Backës, Dervish Iliazi teqe e Kulmakut, Shaban Prishta. Ali Tomori. . . .

Histori e shkurtër e bektashizmit shqiptar

Kur larg kësaj kohe, Ali Pashë Tepelena, sundimtari i jugut përshkëndijonte valëzat e liqenit të Janinës, ky bektashi u bë myhib i Sheme Baba Krujës. Qemaluddin Shememi Babai çeli gonxhe shqiptare për bektashizmin shqiptar, nën terrore të sundimit, të Ali Pashë. Mirëpo ky dinak siç ishte Aliu, ndërkaq e kishte kuptuar se bektashinjtë, ai dhe të tjerë nën perandorin osmane, ishin të kërcënuar. Kështu u konstruktuan dy harqe të një ure lidhëse shqiptare. Në asnjë vend portreti i bektashizmit nuk ishte shpalosur kaq shumë sa në Shqipërinë e asaj kohe me sundimtar Ali Pashën, ç'ka mund të nënkuptosh se ura e bektashizmit shqiptar si shteti i Ali Pashës, po merte formë. Ali Pasha ka mbajtur në kokë një lloj taxhi me ndarje, sinonim i bektashizmit, duhet të jetë gjithsesi shprehur studjuesit, ky është një realitet historik.

Në historinë e lashtë të bektashizmit ballkanik, është i vijëzuar, rrugëtimi i dervish Sari Salltëkut, frymësjellësit të një grushti diell, nga teqeja e madhe e Haxhi Bektashit, murgëveshësi. Shqiptarizma bektashiane do të shtrihej në hapësira të tjera. Kështu Konica, njohu frymën e Hysen Babait. Kosturi të Kasem Babait. Gjirokastra të Asim Babait. Mirëpo Nasibi Tahir Baba ishte një shenjtor që zbriste Kokojkës, syrit të malit, përball Selenicës për në fshatin Frashër. Samiu, thotë se ai kishte lindur në fshatin e tij. Ishte tyrbeja në teqe. Shenjë e largimit të tij. Që kur Shememi Babai, ëndërronte shtrirjen nënë në shtetin e pashait të Janinës, për në Melçan, përcolli dervishin Abdulla Melçani, për te konakët e teqes.

Qëndërzimi në Tiranë

Bektashizmi me frymën shqiptare dhe dervishët e tij ishte konturuar në dy shekuj. Midis dy shekujve ishin bektashinjtë shqiptar. Ka që besojnë verbërisht se shekulli XIX, i përket orë ëndërrës. D. m. th, shekulli i XIX i takon të konturohet si shekulli që solli frymën e shpresës. Ndërkaq për bektashinjtë shqiptar ka zbuluar kohën e shkëputjes nga bektashizmi turk, pra një lloj divorci është shprehur një studjuese e huaj. Mirëpo për të vënë në lëvizje kohën kur në dekadën e dytë të shekullit të XX, kur shqiptarët me shtetin e tyre në përpjekje për ta konturuar, një pike i ngjasonte kjo një lojë të panjohur: "Ngrih e rrëzo, Rrëzo e ngrih", që ishte historia e vetvetes, ose paqyra e postpushtimeve, bektashinjtë e asaj kohe i hapën rrugë kongreseve të bektashisë, që më së paku do të shpallnin mëvetësin e foltoreve, gjuhën shqipe në krye të ritualeve fetare, për të ritreguar rrugën e shqiptarizmit edhe të tjerëve. Fytyra e këtyre kongreseve shprehte veçanti. Duhet përmendur se në Haxhibektash, të tilla nuk kryheshin. Ana tjetër rëndësore është se pjesmarrësit e tyre në mbledhjen e parë ishin dervishët patriot që nga rilindja në pavarësi e me tej. Kongresi i parë me fytyrë shqiptare u bë në Prishtë. Cerdhja atdhetare e teqes zgjoi edhe mendimin shqiptar. I përket datimi 1921. Shkruajmë emra patriotësh dervish shqiptarë:

Baba Ahmet Turhani, Baba Sulejman Gjirokastra. Baba Xhemal Përmeti. Baba Ahmet Elbasani. Baba Kamber Prishta. Baba Mustafa Frashëri. Baba Hajdar Turhani, Baba Hasan Krahësi, Baba Hasan Memalia, Baba Kasëm Koshtani, Baba Sulejman Kicoku, Baba

Ramadan Qatromi, Baba Xhafer Tomorica, Baba Halim Therepeli. Në vijueshmëri kongresi i dytë. Teqe :Hajdarie. Gjirokastër. Datimi 9 korrik 1924.

Kongresi i tretë . Përcakton rëndësi për ardhjen e kryegjyshitës. Pra qëndërzimi i saj në Shqipëri. Kongresi i tretë është përcaktuesi për fatin e bektashizmit botëror. Në 5 tetor 1929, teqe e Turhanit.

Në të tilla rrethana, qendra botërore e bektashizmit do të vendosej në tokën e shqiptareve. Për të caktuar definitivisht kërkohej edhe një moment tjetër. Ai ishte emri dervishit shqiptarit, që do të duhej të ishte udhërrfyesi kur në Turqi në kuadër të masave, tarikatet dhe kultet e tyre do të përfundonin misionin shekullor.

Kur rezidenca qendrore e urdhërit të bektashizmit u vendos të ngrihet në kryeqëndren e Shqiperisë, në kodrinat e buta të periferisë së Tiranës, në fillim të viteve '30, shqiptarët nuk u befasuan për ekzistencën e saj. Përkundrazi, bektashizma shqiptare si trashëgimtare e këtij thesari të shenjtë, dëshmoi fuqinë tonë shpirtërore. U shfaq në një periudhë të caktuar të kohës bektashiane. Mulliri i kohës shqiptare kishte ngecur në vend. Shfaqja ishte goditje meteorësh. Bektashizma shqiptare erdhi si një klithmë shpirtërore për shqiptarët në ditët e përndritjes kombëtare. Bektashizmi depërtoi në thellësi të shpirtit shqiptar si vetmi besim atdhedashës. Bektashizma shqiptare përmban vlera të vërteta për besimin e popullit. Bektashizma shqiptare erdhi e tillë, sepse kishte një arsye të thellë historike. Kishte mungesë të shqiptares në besimet fetare. Rilindasit, krijuesit e ëndërrës për Shqipërinë janë gurëvënësit e parë në themele të bektashizms shqiptare. Bektashizma është shtjellë qiellore. E paisur jo në pak kohe, por në shumicën e shekujve me urtësinë e lashtë. Është mërmërimë pranverore, pa kufij stinësh. Është fuqi , misterioze me origjinë hyjnore, që të turbullon në cektinën e pafundme të shpirtit. Bektashizma është ky besimi, që ka punuar dhe punon për shqiptaret. Ndërsa shqiptaret nga ana e tyre e përpinë bektashizmin për disa arsye:është ekzistencë shpirtërore, filozofi jete, pasuri kombëtare, histori kombëtare. Që kur mori formë komuniteti bektashian shqiptar, kur u mblodhën kongreset dhe funksionimi i tyre ishte i plotë, u pa se çdo të thoshte Shqiperi, në besimet fetare. Në kongresin e tij të parë është sanksionuar gjuha shqipe, gjuha zyrtare e këtij besimi. Kjo është simetria, që mbante kahje të kundërt me të

tjerët. Kjo ishte njëkohësisht ngritja e bektashizmit në sytë e shqiptarëve. Me forcën e tij të shpirtit ngrohën venat e ngrira të kombit. Një dervish shqiptar ka thënë këtë pasazh dashurie për vendin e tij: **"Neve s'na sos Perëndia, se na ka ngjizur vetë / Do të rrojë Shqiperia, sa të përmbysët kjo jetë."** Kjo nuk është muze. Ajo është përpjekja e atyre rilindasve, që në çdo ditë e çdo stinë, plotësuan kronikën e madhe të përndritjes kombëtare shqiptare. Ajo është "vula", për kombin tonë. Jemi këtu, thotë ky dervish, që kur s'mbahet mend. Ky dervish është baba Meleq Shëmbërdhenji, rilindas i shquar. Nga thellësia e kohës dëgjojmë klithmen e dervishit rilindas. Duket, se prej andej ka mbritur aksioma: "Pa atdhe, ska fe", rubin i parë në këto themele, ishte libri i këtij dervishi, "Besim e fe". Këtu jemi, që kur dielli e hëna s'kishte lerë, është shprehur poeti bektashi Naimi ynë. Këta dervishër me shpirtëra shenjtoresh me mendje të kthjelluar, unanimisht do të vërtetonin me mijëra fletë poezi, histori, studime se kjo është toka, që ne shqiptarëve na e dha Zoti. As pushtimet, sado të rënda, sado të zeza të jenë, një ditë do ta këpusnin qafën. Arsyeja: kjo është toka e shqiptarëve. Zoti, na e ka dhënë hisen në Ballkan, në Shqipëri. Kombi ynë do të jetojë për aq kohë sa e ka parathënë Zoti. Kur një nga kleriket bektashi, Bektash Kolonja, do të hidhte një nur bukurie teqeve shqiptare: **"O teqet e bektashisë/si trendafili në vesë"**, ku nga të gjitha këto cilësime bektashizmi ariti të përhap valë të fuqishme sizmike edhe në këtë kohë ku jetojmë në këtë shekull të ri, nga kryeqendra botërore e Tiranës, merret me mend se ç'kapacitete, ç'vlera kombëtare, ka paraqitur bektashizmi për shqiptaret, aty rreth viteve 1934, kohë në të cilën u propozua, të bëhej fe zyrtare e shqiptarëve. Kur Kryegjyshata Botërore u vendos në shtëpinë e shqiptarëve, gadishulli i sertë, por malor i Ballkanit, me kufijtë dhe nacionalitet kishte pjellur, ndonëse më pak se sherret e egra, luftra të përgjakshme fqinjësie.

Shtrirja e ëndërrës

Kur kryeqendra e përbotshme e urdhërit të bektashizmit u vendos në truallin e shqiptarëve, koha e shekullit e shtriu ëndërrën tonë në disa pjesë. E para: ëndërra për një shtet shqiptar. E dyta: përpjekja për të

ndalur kirurgjinë e fqinjëve. Pabesia e tyre e tyre preu nga trojet shqiptare. Pjesët jashtë saj, kullonin gjak e lotë shqiptarësh. E treta: Ardhmëria. Në vitin 1999 u çlirua Kosova, nga pushtimi i shkajut serb. Një lëvizje më ndjeshmëri sizmike e shoqëruar me çlirimin shpirtëror ka filluar në trojet e tjera shqiptare, kjo do të sjelli një ditë, shqiptaret të kenë kombin e tyre. Kur kryqendra botërore e bektashizmit u vendos në kryeqëndren shqiptare në periferi, poeti bektashi Naim Frashëri kishte 31 vjet, që kishte shkuar me sytë e ngrirë në katakombet e ftohtë, i mbyllur në arkëmorti, në varrezën e Medrin Qojt. Por përpara se tek poeti ynë të ndriçonte ora e territ, ai ishte adresuar me një lutje shenjtore Zotit: **"Jepi shqiptarit drite / Zot i vërtetë të shohë / të marre vesh mirësit / të vërtetën ta njohë."** Midis atij trazimi të jashtëzakonshëm shpirtëror, që kishte ndodhur në Ballkan e kishte bërë poetin tonë por edhe dervishët dhe rilindas të tjerë të kërkonin për ndihmë edhe rrugën e frymës, sepse nga të gjithë ballkanasit, ishin populli më i sfilitur nga shekujt e pushtimet. Kur perëndimi i trazuar i shekullit të 19 ndodhi, trojet shqiptare, gjëndeshin në një udhëkryq me ulurima ujqësh, kur mulliri i religjioneve shqiptare u ndal në vend, një venë e bektashizmit shqiptar, ishte teqja e Frasherit. Statusi religjionar në hartën bektashiane, ishte zëri i bektashizmës shqiptare. Rilindja kombetare vërtetë u finalizua në një qytet trojesh shqiptarësh me emrin Prizëren, por zanafillën e saj pjesa jugore e kishte në një teqe me emrin Frashër. Kur në atë mbretëri heshtjesh religjioze shqiptare, s'përpinte askush, bektashinjtë shqiptare nxorren aksiomen me dy rradhë verbuese: **"Pa atdhe s'ka fe"**. Kur flauti i endrres rilindase zgjoi nga gjumi ëndrrën, thesari **"Pa atdhe, s'ka fe"**, Bektashizmi për shqiptaret ishte :Diagrami i rrahjeve të zemres shqiptare. "Sizmografi", që përcaktonte grafikun e ekzistences në shkumbëzimin e valëve në bregun e shpirtit shqiptar. Diagrami i rrahjeve të zemres, që do të mund të maste detin e shpirtit shqiptar. Në përmasat, që e kërkonte koha ishte ngjizje me dehje mistike, tregues domethënës, ishte.

Sali. Nj . Dedei është thirur nga Ankaraja dhe në vitet '30, filloi organizimin e qendrës botërore të bektashizmit. Pas një dekade fronizimi në dheun e tij ai bleu toka për kryegjyshatën, ai përgatitet për një vjeshtë të vështirë. Në vjeshtën e vitit '41, pas një jetë tërmetore shpirti i tij shkoi të sundoi në qiell. Trupi i tij gjendet në

tyben e tij në kryeteqen e Tiranës. Tyrbja e tij kozmike rrethore me gjysëm hënë shqyrton, se shpirti i shenjtorit ndodhet tani në zonën kozmike. Shkuarja e Sali. Nj. Dedeit është bërë pasi ai i kishte përfunduar edhe misionin e fundit të ringritjes së kryeqendrës botërore në Tiranë. Aty tek kryegjyshata kamë parë një çezmë uji që i kushtohet Sali Dedeit. Ujërat sigurisht që shqyrtijnë rrjedhjen e jetës, ose më e saktësuar lëvizjen e urdhërit. Trupin e shenjtorit e mban tyrbja e tij. Në pikëzim të veses, një pëllumb krahet tund çdo mëngjez duke u ulur në tyrbën e tij.

700 VJET

Kur koha solli rrethana, që Kryegjyshata Botërore të ngrihet në Shqiperi, urdhëri i bektashizmit kishte 700 vjet, që ekzistonte. Kur rregjimi i M. Qemalit në kuadër të reformave kyçi dyert e institucioneve fetare të bektashizmit në Turqi, në Tiranë u vendos, selia e shenjte e Kryegjyshates Botërore të Bektashizmit. Kur selia e shenjtë e Kryegjyshates Botërore të bektashizmit bëri 70 vjet jetë në Shqipëri, në Tirane rezidenca e kryegjyshates botërore është kryeqendra e parë, por e vetme midis religjioneve shpirtërore, që selia e saj e përbotshme është në tokën e shqiptarëve

KOSOVA NË MES HIMNIT DHE KUSHTETUTËS

Akademik Zeqirja BALLATA

Flamuri shtetëror i Kosovës u bë si u bë dhe është mëkat që s'përfshiu ndonjë element identiteti, ngjyre a shenjë karakteristike vendore të popullit shumicë. Konsideroj që Plani i Ahtisaarit s'është e thënë që duhet duhet aplikuar fjalë për fjalë. Po të merrnin pjesë në përzgjedhje shumica vendorësh historianë, profesionistë t'artit, njerëz tjerë të dijes e të pendës, mbase mund të pritej ndonjë element i tillë.

Karakteristikë e një vendi a populli zor se mund të mirren gjashtë yjtë që përfaqësojnë gjashtë entitete, prej të cilave shqiptarët përbëjnë 90% të të gjithë banorëve, pesë entitetet tjera së bashku 10%. Zor se mund të vlerësohet si shenjë karakteristike e një populli a vendi edhe figurimi në Flamur i kufijve; kufij që - për fat të keq - s'ditem a s'mundem t'i sigurojmë e mbrojmë pas luftës më 1999, as tash e gati tri javë pas Pavarësisë s'janë duke i zotëruar tërësisht paqëruajtësit. Do t'ishte e nevojshme që këta më me këmbëngulje t'iu bëjnë ballë turmës së demonstrantëve, të cilët po na i rrënojnë e djegin kufijt, të yshtur nga udhëheqësit e tyre me mendësi kolonialiste e mitomane që ende s'e kanë të qartë se Mesjeta ka mbaruar me zbulimin e Amerikës. Pra, »...Trupat mike ndërkombëtare paqëruajtëse në Kosovë...e ShPK e Kosovës ...t'i ruajnë e mbrojnë kufijtë e saj...në rast se ekstremistët nga veriu i Kosovës a jashtë saj ... krijojnë ekscese« (shih Z. Ballata, Vendimi për pavarësi do të jetë sovran, jo i njëanshëm, Bota sot, 28 tetor 2007). Për ndryshe, problemet me kufirin serb, po s'u mbrojt sa duhet, mund të mos kanë të ndalur edhe në t'ardhmen!

Sidoqoftë, Flamurin e Kosovës, si njërin nga simbolet shtetërore e kemi, kështu siç e kemi dhe ky element tash është »ad acta«.

Për një Kushtetutë të pavarur

Tani do pasur kujdes që Kushtetuta, si akt më i lart juridik shtetëror, të miratohet duke u përfshirë drejt e qartë në të çështjet më kruciale që

e përcaktojnë Mendoj që, krahas mbështetjes së saj në vija të përgjithëshme në Planin e diplomatit finlandez, duhet të inkorporohen në Kushtetutë edhe sugjerimet, plotësimet e vërejtjet e arsyeshme si dhe detajet e finesat specifike të ekspetrtëve e institucioneve, organizatave e asociacioneve që nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës e deri te bashkësitë lokale që u dhanë gjatë diskutimit publik dhe të të miratohen nga Parlamenti në mënyrë të pavarur. Do t'ishte mirë që të ndërrohen mjaft fjalë të huaja (komunitetet, mocioni, seancat, presidenti, kuorumi, amendamentimi, asociimi etj.) në ato shqipe dhe të ndërrohen disa terma (kushdo, konfesionet, liria akademike etj.) me të tjerë më adekuatë (nenet 24, 39, 48). Do t'ishte e arsyeshme të rishikohen nenet ku flitet për gjuhët (neni 5), simbolet (neni 6), Forcën e sigurisë (pse jo Forcat e armatosura, si në vendet tjera, neni 126), Përbërjen e përkohëshme të Këshillit gjyqësor e të Gjykates kushtetuese (nenet 151, 152, pse ...e përkohëshme?); gjithashtu edhe nenet ku flitet për vendet e rezervuara a të garantuara për komunitetin serb (neni 78:...), ndërkohë që nuk përmendet populli shqiptar n'asnjë nga 160 nenet e 61 faqeve të Projektkushtetutës (!!!), ndonëse Kosova është formuar pikërisht për këtë popull; popull që jetoj e jeton në troje etnike, pasardhës Dardanësh e të Dardanisë ilire për të vazhduar të gjallojë gjatë Mesjetës dhe dyndjeve të Sllavëve, të cilët u vendosen përreth Kosovës për ta pushtuar atë në shek. XIII dhe sunduar afro dy shekuj e gjysëm deri në pushtimin Osman, kur Shqiptarët, karshi popullatës pakicë ortodokse serbe ishin shumicë, përfshirë edhe periudhën pas pushtimit të Kosovës nga serbët më 1912, e cila mbet' e okupuar deri më 1918, më pas edhe në Mbretërinë serbo-kroato-slllovene, por edhe pas Luftës II botërore në Jugosllavi deri në kapërcim të shekullit që kemi hyrë; popull që i duroi katrahurat e luftërave ballkanike e botërore, pastaj gjatë viteve '50-'60, '80 e '90 në këtë Kosovë historikisht ekzistente që n'Antikë (Dardania), Mesjetë (Kosova), gjatë pushtimit Osman (Vilajeti i Kosovës) dhe gjatë Federatës Jugosllave deri më sot (Kosova); popull që hoqi të zitë e ullirit nën Jugosllavi prej nga u dëbua me dredhi e dhunë në Turqi me anë traktatesh e elaboratesh antishqiptare (V. Çubrilloviq, »Iseljavanje arnauta, 1937, »Manjinski problem u novoj Jugoslaviji«, nëntor 1944; B. Križman, »Elaborat dra Ive Andrića o Albaniji, 1939 etj.) e u detyrua të mërgojë mbas Luftës II botërore në vende europiane e tejoqeanike për kafshatë

goje, si dhe për t'i shpëtuar ndjekjeve mizore të hegjemonistëve; popull nga më të vjetërit të civilizimit europian dhe me personalitete të shquara (Gjergj Kastrioti, Andrea A. Durrësaku, Leonik Tomeo, Marin Barleti, Mimar Sinani, Elena Gjika, Aleksandër Mojsiu, Sami Frashëri, Nëna Terezë - Gonxhe Bojaxhiu etj.), i cili s'ka okupuar a sunduar të tjerë, përkundrazi është ndrydhur nga trysnitë e dyndësve dhe sunduesve të ndryshëm.

Himni të jetë vendor

Në këtë kuadër, do shpallur edhe konkursi e përzgjedhur Himni me tekst e muzikë shtetëror i Kosovës. Më parë do përzgjedhur teksti poetik, pastaj mbi të do të kompozohet e përzgjedhet muzika – melodia e kompozuar. Kjo nuk duhet bërë me nguti. Çështja e Himnit s'është e re: për të është folur më 1990 pas Deklaratës së 2 korrikut (Rilindja, 3 korrik '90, fq. 1-3 dhe 4 korrik, fq. 4-7), pas shpalljes së Kushtetutës së Kosovës më 7 shtator '90 e të Ligjit kushtetues për zbatimin e saj («Dielli», nr. 7, Zagreb, shtator '90) nga Kuvendi që e pat' shtruar çështjen e himnit...; e pat' aktualizuar edhe gazeta «Dielli» në Zagreb dhe shpallur konkurs («Dielli», nr. 5-10, shtator-tetor '90) për tekstin e muzikën dhe lidhur me këtë pat' ndërhyrë autori i këtij shkrimi (Z. Ballata, Mbi çështjen e himnit, Bota e re, 6. dhjetor 1990). Ndërkaq, tash duhet ta kemi përfundimisht himnin.

Në Planin e Ahtisaarit janë paraparë shumë favore për entitetet joshumicë, sidomos atij serb. Por të drejtat dhe detyrimet bashkë me simbolet, pra edhe Flamurin, stemën e Himnin (neni 6: Flamuri, stema dhe himni janë simbole shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj!) bashkë me specifikat e popullit shumicë konsideroh që duhet ta zënë vendin adekuat. Kështu edhe autorëve të himnit s'është e drejtë t'u vehen udhëzime si ta krijojnë tekstin a muzikën, me apo pa elemente metriko-ritmike, melodike të idiomit vendor, si t'a kompozojnë muzikën e himnit, me a pa elemente vendore. Udhëzimet e tilla e cungojnë të drejtën e lirisë krijuese. Vënja në pah e elementeve muzikore vendore është e drejtë e natyrëshme dhe e pacenueshme e krijuesit muzikor.

Një melodi e karakterit solemn, himnik, siç pritet të jetë Himni i Kosovës, natyrisht që mund të ketë ndonjë element melo-ritmik a melodik vendor nëse duam që ta përqafojnë shtetasit. Po nuk pat'

melodia elemente të tilla, çfarë elementesh atëherë u dashka të ketë dhe nga cili vend a popull për t'u përqaftuar sa më lehtë? Himni i Kosovës me popullatë më monolite si pak vende të tjera (Maqedonia, Bullgaria, Serbia, Rumania, Kroacia, Sllovenia, Austria, Zvicra, Sllovakia etj.), është e natyrshme që të ketë ndonjë element vendor, ndonëse arti i tingujve është mjaft abstrakt dhe secili dëgjues e pranon në mënyrën e vet. Direktiva në këtë drejtim nuk ndeshen në krijimtarinë përgjithësisht muzikore ndër popuj të civilizuar.

Pas përpilimit të kushteve të konkursit për sajimin e himnit që do ta bënin profesionistët e afirmuar muzikorë me shkallë e përvojë të pasur pedagogjike e krijuese-artistike, do të merrnin pjesë sa më shumë krijues muzikorë. Në komisionin profesional për vlerësimin dhe përzgjedhjen e himnit do t'ishin krijues që për një a tjetër arsye nuk marrin pjesë në konkurs. Pas shpalljes së konkursit për tekstin e himnit dhe përzgjedhjes së tij, do të pasonte konkursi për muzikën - melodinë e kompozuar mbi atë tekst. Poqese organet e Kosovës shpallin konkurs vetëm për kompozimin e melodisë pa tekst, atëherë ka gjasa që një numër prej nesh nuk marrin pjesë, sepse himni pa tekst është i mangët, i cunguar dhe nuk i përmbush, në kuptimin e mirëfillt, kushtet e himnit të plotë të një shteti. Është e njohur praktika që t'u kërkohet autorëve muzikorë që - mbi bazë të tekstit të zgjedhur - të konkurojnë më parë me melodinë (në të shumtën e rasteve me shoqërim të pianos), ndërsa pas zgjedhjes nga komisioni profesional, t'i besohet një a disa kompozuesve për orkestrim (që kërkon punë paksa më të gjatë profesionale e kohore). Pasi të jenë orkestruar (e incizuar) meloditë, duhet bërë përzgjedhja sa më objektive e himnit. Një himn i tillë i sajuar shtetëror, kësodore, do të përvetësohej lehtë e shpejt nga populli, ndërsa prania e idiomit a specifikave relevante melo-ritmike e metrike vendore do ta bënin atë më të përvetësueshme e të dashur për t'u kënduar çdo herë kur të jetë nevoja.

Organet e Kosovës, në konsultë me poetë, kompozues e (etno) muzikologë, në vend të shpalljes së konkursit për himn e përzgjedhjes së tij, mund të vendosin (siç kanë vepruar disa shtete) që ta pranojnë për himn shtetëror melodinë "Kur u dha kushtrimi" (të sugjeruar që më parë nga Kryetari Rugova).

Së këndejmi shpresojmë që, për të gjitha këto arsye dhe pas të gjitha vuajtjeve e travajeve, persekutimeve e shpërnguljeve, torturave e flijimeve të njerëzve të pendës e të pushkës, të grupeve ilegale e të

hapura në vend dhe jasht e deri te lufta e armatosur e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës kundër veprimeve gjenocidale, dëshmorëve e heronjve të rënë, pleqëve, fëmijëve e grave të masakruara e të dhunuara, Parlamenti i Kosovës, Kryesia e Qeveria do të vendosin me kompetencë për Kushtetutën e Himnin dhe kështu të përfaqësohet Kosova, vërtetë, shtet i pavarur e sovran.

nga gjuha shqipe dhe anglisht. Në këtë antologji autori i sjell lexuesit shqiptar 35 poetet me 35 famshëm shqiptar, si dhe një vështrim për fillet e të shkrimit të shqipes. Si rezultat vërejtjeje që vështrim të botojmë në tërësi. Kjo më parë nga po i njëjti autor foli nga shtypi në shtëpinë botuese Tuna të Lublanës romanin «prilli i thyer» («Zlomljeni april») të shkrimtarit shqiptar me famë botërore Ismail Kadare. përkthej në gjuhë shqipe

Prekje kulturore e gjuhës shqipe

VESHTRIM PËR SHKRIMIN NDER SLOVENËT

Nikollë Derishaj

Fillet e para të fjalës së shkrimit shqipe janë ngusht të lidhura me manastiret mesjetare si vatrë e veprime e jetës kulturore. Në të folën shqipe vazhdueshmërisë së shkrimit në trojet shqipe, kaptohet në fillim në gjuhën e privilegjuar të kishës katolike, në gjuhën latine. Në Dolenjska kështu, kemi të vërejtura të kishës, manastiret S. Maria /S. Maria/, vendlinja dhe Kostanjevica. Përpos këtyre manastireve më tej i kemi fol të njohur dorëshkrimet më të rëndësishme, ajo i gjatë edhe në pjesët tjera të territorit të sotëm shqiptar si në Zvezda /Zvezda/, Jurkloster /Jurkloster/, Blistra dhe Pleterje.

Shënimi i parë i ruajtur daton nga para vitit 1000 (që merret edhe si dokumenti i parë në gjuhën shqipe) Blizinski /Blizinski/, Blizinski /Blizinski/ pomeniki/. Pasi që në këtë kohë në trojet shqipe nuk janë ende të organizuar manastiret, vlerësohet se ky shënim (i gjetur më 1803) është bërë si nevojë e rastit e kishës. Shënimi tjetër na vjen nga viti 1227, kur klasa e lartë e Koroshkës e pret poetin gjerman Ulrichun nga Uchtenshtajni me përshëndetjen shqipe; kurse, që nga viti 1414 kjo vërejtje e vetë shqiptarët i kurorëzojnë duke përdorur gjuhën e tyre. Mund të thuhet se tradita e shkrimit shqiptar fillon diku afro 900 vjet, megjithatë në fillim me një numër të vogël të dokumenteve

kompetencë për krijimin e himnit të shtetit të Kosovës, të cilin do ta përdorim si himn të shtetit të Kosovës. Komiteti i Kulturës dhe Artit të Kosovës, në bashkëpunim me Komitetin e Kulturës dhe Artit të Kosovës, do të organizojë një konkurs për himn të shtetit të Kosovës. Komiteti i Kulturës dhe Artit të Kosovës, në bashkëpunim me Komitetin e Kulturës dhe Artit të Kosovës, do të organizojë një konkurs për himn të shtetit të Kosovës. Komiteti i Kulturës dhe Artit të Kosovës, në bashkëpunim me Komitetin e Kulturës dhe Artit të Kosovës, do të organizojë një konkurs për himn të shtetit të Kosovës.

Pas përpilimit të kushteve të konkursit për sajtimin e himnit që do të bënin profesionistët e afirmuar muzikorë me shkallë e përvojë të pasur pedagogjike e krijuese-artistike, do të marrin pjesë sa më shumë krijues muzikorë. Në komisionin profesional për vlerësimin dhe përzgjedhjen e himnit do të jenë krijues që për një a tjetër arsye nuk

Prekje kulturore e gjuhës sllovene

dhe përzgjedhjes së tij, do të pasonte konkursi për muzikën - melodinë e kompozuar mbi atë tekst. Poqese organet e Kosovës shpallin konkurs vetëm për kompozimin e melodisë pa tekst, atëherë ka gjasa që një numër prej nesh nuk marrin pjesë, sepse himni pa tekst është i mangët, i cunguar dhe nuk i përmbush, në kuptimin e mirëfillit, kushtet e himnit të plotë të një shteti. Është e njohur praktika që t'u kërkohet autoreve muzikorë që - mbi bazë të tekstit të zgjedhur - të konkurojnë më parë me melodinë (në të shumtën e rasteve me shprehim të pianos), ndërsa pas zgjedhjes nga komisioni profesional t'i besohet një a disa kompozuesve për orkestrim (që kërkon punë paksa më të gjatë profesionale e kohore). Pasi të jenë orkestruar (e incizuar) meloditë, duhet bërë përzgjedhja sa më objektive e himnit. Një himn i tillë i sajuar shtetëror, kështu, do të përvetësohej lehtë e shpejt nga populli, ndërsa prania e idiomit a specifikave relevante melo-ritmike e metrike vendore do ta bënin atë më të përvetësueshme e të dashur për t'u kënduar çdo herë kur të jetë nevoja.

Organet e Kosovës, në konsultë me poetë, kompozues e (etno) muzikologë, në vend të shpalljes së konkursit për himn e përzgjedhjes së tij, mund të vendosin (siç kanë vepruar disa shtete) që ta pranojnë për himn shtetëror melodinë "Kur u dha kushtrimi" (të sugjeruar që më parë nga Kryetari Rugova).

Së kendejmi shpresojmë që, për të gjitha këto arsye dhe pas të gjitha vuajtjeve e travajeve, persekutimeve e shpërnguljeve, torturave e filjimeve të njerëzve të pendës e të pushkës, të grupeve ilegale e të

Në shtëpinë botuese Toena në Tiranë, me përkrahje të Minsitrisë së Kulturës së Republikës së Sllovenisë, doli nga shtypi **Antologjia e poezisë bashkëkohore sllovene** të cilën me zell të madhë e përzgjedhi e përgatiti dhe e shqipëroi Nikollë Berishaj, përkthyesi më në zë në ndër shqiptarë nga gjuha sllovene në gjuhë shqipe dhe anasjelltas. Në këtë antologji autori i sjell lexuesit shqiptar 33 poetët më të famshëm slloven, si dhe një veshtrim për fillet e të shkruarit tek sllovenët. Si redaksi vendosëm që atë veshtrim të botojmë në tërësi. Kohë më parë nga po i njëjti autor doli nga shtypi në shtëpinë botuese Tuma të Lublanës romanin »prilli i thyer« (**»Zlomljeni april«**) të shkrimtarit shqiptarë me famë botërore Ismail Kadare. përkthej në gjuhë sllovene

VËSHTRIM PËR SHKRIMIN NDËR SLLOVENËT

Nikollë Berishaj

Fillet e para të fjalës së shkruar sllovene janë ngusht të lidhura me manastiret mesjetare si vatër e vetme e jetës kulturore. Në to fillon tradita e vazhdueshmërisë së shkrimit në trojet sllovene, kuptohet në fillim në gjuhën e privilegjuar të kishës katolike, në gjuhën latine. Në Dolenjska kështu, kemi tri vatra të kulturës, manastirin Stična /*Stična*/, Vetrinja dhe Kostanjevica. Përpos këtyre manastireve prej kah i kemi sot të njohur dorëshkrimet më të rëndësishme, ato i gjejmë edhe në pjesët tjera të territorit të sotëm slloven si në Žižce /*Žižce*/, Jurklošter /*Jurklošter*/, Bistra dhe Pleterje.

Shënimi i parë i ruajtur daton diku para vitit 1039 (që merret edhe si dokumenti i parë në gjuhën sllovene) **Brizhinski spomeniki** /*Brižinski spomeniki*/. Pasi që në këtë kohë në trojet sllovene nuk janë ende të organizuar manastiret, vlerësohet se ky shënim (i gjetur më 1803) është bërë si nevojë e rastit e kishës. Shënimi tjetër na vjen nga viti 1227, kur klasa e lartë e Koroshkës e pret poetin gjerman Ulrikun nga Lichtenshtajni me përshëndetjen sllovene; kurse, që nga viti 1414 vojvodët e vetë sllovenët i kurorëzojnë duke përdorur gjuhën e tyre.

Mund të thuhet se tradita e shkrimit slloven shënon diku afro 900 vjet, megjithëse në fillim me një numër tejet të vogël të dokumenteve

të ruajtura. Si kompensim për mungesën e shtypshkronjave në këto troje (shtypshkronjat më të afërta ishin në Videm, Çedad, Mynih, Venecie, Vjenë ...) në trojet sllovene u zhvillua arkitektura dhe pikturat murale kishtare.

Edhe përkundër kësaj, sllovenët nuk vonojnë në krahasim me fqinjët sa i përket librit të parë. Më 1550¹ **Primozh Trubar** /*Primož*/ boton *Chatechismus*-in e vet. Një vjet më vonë veprën tjetër *Abecedarij*. Bashkëkohësi i tij dhe shkrimtari më i emancipuar protestant slloven, Sebastijan Krelj, më 1566 boton *Otročja* /*Otročja*/ *biblija* (Bibla për fëmijë)

Hyrja e shtypshkronjës së parë në Slloveni rezulton me fillimin e botimit të përkthimit të plotë të Biblës (botimi përfundohet në Gjermani – Vitenberg, më 1584), të cilën në gjuhën e popullit të vet e solli **Jurij Dalmatin** (1547-1589). Anëtar i Komisionit Revidues të Biblës së Dalmatinit, **Adam Bohorič** /*Bohorič*/, duke e hetuar mungesën e rregullave të shkrimit në gjuhën sllovene, në vitin 1584 në Vitenberg e boton gramatikën e parë sllovene në latinisht. Veprën e parë të rëndësishme historiko – etnografiko – gjeografike (për këto treva, por në gjermanishte), por duhet pranuar pa distancë të mjaftueshme shkencore, e shkroi **Ivan Vajkard Valvasor** - *Slava vojvodine Kranjske*², në hyrjen e të cilës e hasim poezinë e parë jokishtare sllovene /*Zaščitno vošenje te Kranjske dežele*/ të shkruar nga **Jozhef Zizenčeli** /*Jožef Zizenčeli*/. Retorika, që në mesjetë u shndërrua në një teori të plotë të komunikimit letrar³ gjeti edhe ndër sllovenët dy përfaqësues të denjë: **Janez Svetokriški** /*Svetokriški*/ e veçanërisht **Jernej Basarin**, emri i të cilit u bë i njohur në tërë Evropën e kohës. Letërsia sllovene, pra, deri në vitet 1768 është gati kryekëput letërsi kishtare, përpos shkrimeve në të përkohshmen *Kranjska pratika* (që fillon të dalë më 1725).

Paraqitja e iluminizmit në Evropë ndikon në ngritjen e vetëdijes kombëtare edhe te ky popull. Vitet 1809 – 1813 janë ngushtë të lidhura me formacionin shtetëror **Ilirska pokrajina**⁴, të krijuar nga Napoleoni pas fitores mbi Austrinë. Edhe pse zgjati pak, bota sllovene pas rrënimit të këtij “shteti” nuk ishte më si përpara. Reformat e futura nga vet Napoleoni, pavarësisht që u qitën jashtë ligjit, lanë pasoja në vetëdijen e popullit duke nxitur Rilindjen kombëtare sllovene, ku bëjnë pjesë grupe të ndryshme intelektualësh si: meshtarët (**Marko Povlin**), janzenistët (**Jurij Japelj**), anëtarët e Akademia Operosorum (**Blazh**

/Blaž/ **Kumerdej**, **Anton Makovic**, **Martin Kuralt**) dhe rrethi i Cojsit (Baroni **Zhiga** /Žiga/ **Cojs**, **Anton Tomazh** /Tomaž/ **Linhart**, **Valentin Vodnik**, që më 1806 boton përmbledhjen e parë poetike ndër sllovenët *Pesmi za pokushino* /pokušino/).

Romantizmi te sllovenët paraqitet si ide udhëheqëse por e ndarë në disa drejtime: në Romantizmin e vjetër dhe në Romantizmin e ri slloven, kurse për nga idetë udhëheqëse diferencohen dy: ajo e pansllavizmit (fillimisht ilirizmit) në njërën anë dhe e ngritjes së vetëdijes nacionale sllovene (idpendetizmit) në anën tjetër. Romantizmin e vjetër slloven e prezanton më së miri **Jernej Kopitar** (1870 – 1844), censori i oborrit mbretëror në Vjenë, qëndrimi kryesor i të cilit do të mund të definohej me kërkesat për një literaturë moraliste, edukative dhe të thjeshtë. Shpëtimin e kombit slloven dhe të gjithë sllavëve tjerë të jugut e shihte brenda monarkisë austriake. Si bibliotekar i Oborrit të Vjenës i jep detyrë **Vuk Karaxhiqit** /Karadžić/, që krahas vjeljes së materialit folkloristik serb të bëjë edhe shënimin e këngëve popullore shqiptare. Me të fillon edhe interesimi i plejadës së linguistëve sllovenë për gjuhën shqipe. Teoritë e tij mbi letrarësinë në gjuhën “e fshatarëve” (duke marrë parasysh vendin që e mbulonte – vendin e censorit) shpesh penguan zhvillimin e letërsisë së mirëfilltë sllovene. Përkundër tij, përfaqësuesit më eminentë të Romantizmit të ri, **Matija Čop** /Čop/ ⁵, e veçanërisht poeti më i madh slloven **France Presheren** /Prešeren/ (1800 – 1849) mbronin qëndrimin mbi lirinë e krijimtarisë artistike dhe të artit në përgjithësi. Siç ndodhë shpesh, lufta në mes të përfaqësuesve të dy botëkuptimeve, apo drejtimeve shoqërore nuk u zhvillua në arenën politike, por fillimisht ishte e iniciuar nga çështjet kulturore. Nga antagonizmat e këtyre dy rrymave lindi e ashtuquajtura Lufta e abecesë (Abecedna vojna), të cilën kryesisht e udhëhoqi Čopi, kurse në arenën letrare ideve të Kopitarit iu kundërvu Preshereni me satirat e tij në vargje⁶.

Viti 1848, vit revolucionar për tërë Evropën⁷ pati bujë të madhe edhe ndër sllovenët. Franc Preshereni e përkujtoi këtë me poezinë *Dollia* (Zdravljica), që gjatë kohë merrej si himn (jozyrtar) i kombit. “Sllovenia”⁸ e Vjenës e pranoi programin mbi “Slloveninë e bashkuar” në të cilën do të hynin të gjitha krahinat sllovene (Kranjska, Koroshka /Koroška/, Primorska).

Krijuesi i sllavistikës së re, **Franc Miklloshiç** /Miklošič/ (1813-1891) me veprat linguistike e leksikologjike vuri baza të mira të studimet

krahasuese gjuhësore⁹. I kësaj epokë është edhe krijuesi **Stanko Vraz**¹⁰, që në letërsinë kroate njihet si njëri ndër Iliristët e mëdhenj. Pas thyerjes së Revolucionit të 1848 në tokat e sunduara nga Austria fillon Absolutizmi i Bahut (ministrit austriak që likuidoi të gjitha liritë politike: lirinë e shtypit, organizimit dhe marrëveshjes, gjë që mpiri tërë veprimtarinë politike-kulturore. Nga kjo epokë shquhet poeti "pedagogjik" **Anton Martin Sllomshek** /*Slomšek*/. Edhe pse në fillim kundërshtar i flaktë i Revolucionit (të cilin e quan "pjellë e drejt"), më vonë kritikën e veta të ashpra i drejton kundër sllovenëve të gjermanizuar, duke cekur përkatësinë e vet nacionale sllovene, për ç' shkak akuzohet nga Prokuroria Shtetërore ("Drobtinice" 1862).

Vitet 1860¹¹ - 1881 karakterizohen me:

- "Epokën e lexonjtoreve"¹²
- "Dualizmin" në politikën sllovene, dhe
- krijimin e organizatave kulturore të punëtorëve, gjegjësisht, sipas modelit çek, krijimit të shoqërive të gjimnastikës "Sokol"

Në periudhën 1860 – 1870 në të gjitha qytetet e mëdha sllovene: Cele, Celovec (Klagenfurt – Austri e sotme), Goricë, Maribor, Lublanë, Ptuj, Trieste etj. U krijuan 58 lexonjtore (salla të leximit) – /*čitalnice*/, si qendra të jetës kulturore popullore. Në to mblidhej tërë inteligjencia dhe klasa qytetare përparimtare kombëtarisht e vetëdijesuar. Qendra e të gjitha lexonjtoreve sllovene u vendos në Lublanë, që u bë njëkohësisht edhe qendër e inteligjencies përparimtare për mbarë kombin, duke krijuar kështu organizatën "Matica Slovenska" (Amza sllovene) më 1864, e disa vjet më vonë (më 1867) aty u krijua "Dramatično drushtvo /*Dramatično društvo*/"¹³.

Pas disfatës ushtarake të Austrisë nga Prusia dhe Italia (1866), shteti u nda në Austri dhe në Hungari, duke krijuar kështu një dualizëm shtetëror, që e përçau edhe indin kombëtar slloven në dy pjesë. "Dualizmi" ndikoi edhe në politikën dhe inteligjencien sllovene, duke e përçarë kështu në dy grupe, në atë të "**sllovenëve të vjetër**" (grupi konservativ), lojalë qeverisë së Vjenës, që e përfaqësonte **Janez Blajvaz** dhe në atë të borgjezisë liberale "**sllovenët e rinj**"¹⁴. Të pakënaqur me politikën joparimore të përfaqësuesve zyrtarë, inteligjencia e re sllovene e udhëhequr nga shkrimtari dhe dramatiku **Fran Levstik** boton më 1863 revistën Naprej¹⁵, revistën e parë të vërtetë politike sllovene. Përçarja vazhdoi edhe në borgjezinë liberale, duke krijuar

kështu krahun e majtë të saj me Levstikun në krye, që rezulton me botimin e revistës Slovenski narod¹⁶ (1868), me të cilën definitivisht mundet ideja e “sllovenëve të vjetër”.

Pika e tretë karakteristike e epokës në fjalë (krijimi i shoqërive “Sokol” në të gjitha qendrat urbane) ka të bëjë me organizimet masovike të popullatës, para së gjithash rinisë revolucionare sllovene. “Epoka e taborëve” (1868 – 1881) shënon organizimin e tubimeve të hapëta popullore si revoltë ndaj pakënaqësisë me politikën konservative të establishmentit zyrtar. Me këta taborë, lëvizja nacionale sllovene, për herë të parë në histori përfshiri tërë popullin slloven.

Shtypi i rëndësishëm politik dhe letrar (1840 – 1880)¹⁷

Shtypi që e shënoi kohën dhe zhvillimin nacional slloven me një ndarje globale mund të klasifikohen në: shtypin politik dhe shtypin letrar

Shtypi politik

Novice (1843 – botuesi Janez Blajvaz)¹⁸, më 1848 bëhen organ i Kmetijska družba /*družba*/¹⁹ duke u kthyer kështu në revistë politike, që artin e ka vetëm si gjë të rastit. Përkrah idetë e Sllovenëve të vjetër, pra rrymës konservative. Deri më 1868 ishte gazeta udhëheqëse sllovene

Slovenija (1948-1950) - gazeta e parë politike – letrare sllovene, organ i “Slovensko drushtvo /*društvo*/”²⁰. Ishte gazetë liberale, që theksonte kombëtarën, kështu që nuk ishte sipas dëshirës së autoriteteve kishtarë, e as të zyrtarëve austriakë.

Zgodnja Danica (1849)²¹ - gazetë thjeshtë dogmatike katolike në shërbim të Kishës.

Stimen aus Innerösterreich (1861 – 1863)²², gazetë në gjuhën gjermane për kërkesat nacionale sllovene, e boton slloveni i Koroshkës, Andrej Ajnshpiler /*Ajnšpiler*/.

Naprej (1863) – gazetë politike e krijuar nga Miroslav Vilhar dhe e redaktuar nga Fran Levstik. Gazetë që lufton kundër idesë së “sllovenëve të vjetër”, për të drejtat e kombit slloven dhe është e shkruar në gjuhë të rrjedhshme të bukur sllovene. Është gazeta e parë sllovene politike, që e ndalon botimin për shkak të censurës (për shkak të tekstit të F. Levstikut mbi barazinë e popujve), kurse për shkak të tekstit të Miroslav Vilharit mbi kufijtë ndërkombëtarë, autori burgoset.

Slovenec (1865-1867), gazetë, që në mënyrë kritike shqyrton të gjitha çështjet politike-kulturore sllovene. Botuesi Andrej Ajnshtpiler, redaktori Janez Bozhiç /Božič/, Në të botuan autorë nga të gjitha trevat sllovene.

Triglav (1865-1870), gazetë politike në gjuhën gjermane, organ i Sllovenëve të vjetër.

Slovenski narod (1868) redaktori Fran Levstik; u bë organ i intelektualëve të rinj, letrarëve dhe politikanëve, me të cilin ia morën primatin politik garniturës së Sllovenëve të vjetër, gjegjësisht politikës së Blajvazit. Bashkëpunëtorët e saj:

- në aspektin politik kërkonin rregullimin federativ shtetëror të Austrisë si dhe tërësinë administrative të Sllovenisë;
- në aspektin fetar u përcaktuan për lirinë fetare
- në aspektin nacional, kërkonin realizimin e të drejtave të sllavëve të Austrisë.

Pavliha (Vjenë 1870 – F. Levstik) – gazetë humoristike – satirike. Botuesi si mjet të luftës së vet përdorë satirën. Levstiku kritikon ashpër ata që u mbetën lojalë gjermanëve, por nuk e miraton dhunën në luftë. Në Pavlihë kritikohen edhe "sllovenët e ri" të lëkundshëm.

Brencelj²³ (1869-1885 Jakob Aleshevec) – gazetë e ilustruar humoristike. Thumbi drejtohet kundër "Sllovenëve të vjetër".

Klerikalni Slovenec²⁴ thjesht **Slovenec** (1873 – Karol Klun) – përkrah klerikalizmin dhe Sllovenët e vjetër.

Edinost²⁵ (Trieste 1876, Ivan Dolinar). Gazetën e ndalojnë fashistët italianë më 1928.

Shtypi letrar, përmbledhjet letrare dhe shtëpitë botuese

Vedezh /Vedež/²⁶ (1848 – 1850 Ivan Navratil) – gazeta e parë sllovene për të rinjtë. Ka karakter pedagogjik. Boton prozë, poezi, përralla, artikuj historikë, artikuj mbi botën shtazore, gramatikën e shkurtër sllovene, etj.

Gazetat shkollore: nxënësit e Lublanës, Celes dhe Celovcit botonin gazetën e vet *Slavija*, kurse nxënësit e klasës së tetë të gjimnazit në Lublanë botonin më 1855 gazetën **Vaje**²⁷. Nxënësit e teologjisë në Celovec kishin gazetën **Venec**²⁸

Slovenska čbella /čbela/²⁹ (Cele 1850), boton beletristikë. Pas ndërprerjes së botimit gazeta me emrin **Slovenska bčella /bčela/** (1850

-1853) botohet në Celovec nga Anton Janezhiç /*Janežič*/. Gazeta boton shkrime beletristike dhe shkencore. Bashkëpunëtorë të gazetës ishin: Trdina, Svetec, Levstik, Navratil, etj. **Glasnik slovenskega slovstva**³⁰ (Celovec 1854) pas ndaljes së botimit të Slovenska bčela, Janezhiçi fillon me gazetën tjetër beletristike, por del vetëm një numër.

Mohorjeva družba /družba/ (Druzhba /Družba/ sv. Mohorja)³¹ u krijua si shtëpi botuese në propozim në A. Slomshecut me qëllim që të botohen libra të lirë sllovenë. Më 1853 me lejen e qeverisë së Celovecit këtë e themeluan Ajnshpiler dhe Janezhiç. Shoqata themeloi edhe shtypshkronjën e vet, ku botuan kryesisht prozë krijuesit më të mirë të kohës, si: Josip Jurçič /*Jurčič*/, Fran Erjavec, Fran Detela, Ksaver Meshko /*Meško*/, Fran S. Finzhgar /*Finžgar*/, Josip Stritar dhe Ivan Pregelj. Botimet e kësaj shtëpie botuese zmadhuan dashurinë ndaj fjalës së shkruar sllovene.

Slovenski glasnik³² (1858-1868, Janezhiç) revista udhëheqëse letrare e kohës. Botohej në Celovec. Revista veçanërisht e fitoi autoritetin e vet me botimin e poezive të Simon Gregorçičit /*Gregorčič*/ dhe Simon Jenkos, të tregimeve të Levstikut, Erjavecit, Jurçičit si dhe me artikujt kritikë të J. Stritarit. Autorët e shkrimeve luftonin për kritikën e lirën e njëkohësisht edhe kundër monopolizmit të Blajvazit, gjë që edhe u bë shkak për humbjen e një numri të madh të abonentëve nga ana e meshtarëve sllovenë.

Besednik³³ (1869-1878, Janezhiç), pas mbylljes së Slovenski glasnik-ut, Janezhiçi botoi "gazetën për argëtim dhe mësim", ku botoheshin krijime letrare, e në fillim edhe tekste politike.

Cvetje iz domačih /domačih/ in tujih lugov³⁴ (1861-1866, Janezhiç). Revista në fjalë ka rëndësi të posaçme për zhvillimin e letërsisë sllovene. Aty u botuan vepra të shkrimtarëve sllovenë dhe të huaj, përpos tjerash edhe romani i Jurçičit *Deseti brat*³⁵.

Slovenska matica – institucioni i parë letrar ndër sllovenët u krijua me ndihmën e F. Levstikut dhe Lovro Tomanit. Emri i këtij institucioni është i lidhur me luftën për të drejtat nacionale sllovene. Përpos "Letopisi"³⁶, boton edhe poezinë e Valentin Vodnikut (1869) dhe një mori të shkrimeve të autorëve të kohës, si dhe përkthime të veprave të Shekspirit, Gëtes, Pushkinit, Tolstojit, Dostojevskit, etj. Gjithashtu botohet Historia e letërsisë sllovene, Bibliografia sllovene, përmbledhja e këngëve popullore...

Kllasje /Klasje/ ³⁷ (1866, Levstik, Jurçiq, Stritar), ndërmarrje e pavarur botuese. Si librin e vetëm të tyre botuan Poezinë e F. Presherenit, por të “përmirësuar” nga Levstiku, në dëm të origjinalit. Hyrjen në libër, që bëhet historike, e bëri Josip Stritar, pasi që ua zbuloi sllovenëve vlerat artistike të veprës së poetit të madh.

Zvon ³⁸ (1870, Vjenë, Josip Stritar) revista e parë letrare sllovene. I ndihmojnë dy miqtë më të ngushtë Levstik dhe Jurçiq. Me pauza del deri në vitin 1880. Me titull të ngjashëm, por me vend të botimit në Lublanë pas kësaj botohet **Lublanski zvon /Ljubljanski zvon/** ³⁹ (Lublanë, 1881, Jurçiq, Kersnik, Levec, Tavçar), pas të cilit si udhëheqës ideor na paraqitet F. Levstik

Vdekja e poetit të madh slloven, France Presherenit (1849) jo vetëm se e qiti në hije veprimtarinë letrare-artistike të tij dhe të disa “filizave” të letërsisë sllovene, që ndikoheshin nga ai, por për më se një dekenie e zbrapsi atë që mund të krahasohej me prodhimin artistik në kombet e zhvilluara të kohës. Letërsia sllovene, si dhe krejt jeta shoqërore-politike mbeti nën ndikimin e ideve konservative të shkrimtarëve të grupit të ashtuquajtur të “Sllovenëve të vjetër”. Shija dhe arsimimi letrar i lexuesve ishte në nivel tejet të ulët, që u konvenonte ithtarëve të grupit në fjalë, si dhe ithtarëve të monarkisë austriake, por jo edhe atyre, të cilët dëshironin për kombin e vet një ngritje të nivelit kulturor-arsimor. Rëndësi të posaçme për këtë ngritje kishin gazetatat dhe revistat e ndryshme të kohës. Letërsia slloven e viteve 1868 – 1881 e tëra ishte në shenjë të realizmit romantik (Jurçiq, Stritar, Tavçar, Kersnik), kurse me fillimin e daljes së revistës letrare Ljubljanski zvon inicohet periudha e realizmit poetik.

Edhe pse gjatë absolutizmit të Bahut cenohen të gjitha liritë, rreth revistës shkollore (**Vaje**) të nxënësve të klasës së tetë të gjimnazit në Lublanë mbledhet një grup elitist, që më vonë do të lërë gjurmë në letërsinë sllovene. Para së gjithëve këtu bëjnë pjesë: Fran Erjavec dhe Simon Jenko.

Pas Presherenit dhe Levstikut, **Simon Jenko** (1835 -1869) është poeti i parë slloven që në poezi i shpreh ndjenjat dhe mendimet e veta mbi atdheun, jetën dhe dashurinë në mënyrë artistike. Poezitë e para (rreth 50 sosh) i djeg. Bashkëpunon me revistat e kohës ku i boton vargjet e veta. Në Vjenë, ku studion, njihet me poezinë e H. Hajnes. Më 1864 në Lublanë botohet përmbledhja e parë e tij **Pesmi**, që, për shkak të

kritikave të mëdha të klerikëve dhe garniturës së Blajvazit, shtypen në Grac, ngase shtypshkronjat e vendit nuk e marrin përsipër këtë. Në poezi ndikohet nga poezia popullore, të cilën e ngërthen me ndjenjat e veta dhe përjetimet e singerta poetike.

Fran Erjavec (Lublanë 1834 – Zagreb 1887). Edhe pse me konotacion studiues i shkencave natyrore, tregimet e tija të para, të botuara në **Vaje** na paraqesin një shkrimtar të denjë të fjalës sllovene. Shtegtimet e tija të shumta e pasurojnë opusin e tij letrar. Që nga *Veliki Petek*⁴⁰ (1857), *Črtice iz življenja in delovanja učenjaka Šnakšneperlajna*⁴¹ (1858), *Avguštin Ocepek* (1860), *Na stričevem domu*⁴² (1860), *Zamorjeni Cvet*⁴³ (1861), *Huzarji na Polici* (1861)... e krijon vendin e vet në letërsinë sllovene si shkrimtar që në mënyrë të përsosur bashkon njohuritë e veta shkencore me talentin e pamohueshëm letrar.

Me përvojë më se dyzet vjeçare në jetën dhe veprimtarinë letrare **Janez Mencinger** (1838-1912), autor i tetë tregimeve dhe i dy romaneve, udhëpërshkrimeve, satirave, imponohet si vëzhgues i mirë i jetës dhe përshkrues realist i saj. Me satirat e tij renditet në grupin e ithtarëve të rrymës liberale, Vepra e tij letrare nuk reflekton aq prozë të vërtetë artistike, por më shumë prezanton autorin mendimtar, që di të punojë me fjalë.

Hyrja, që ia bëri veprës së Presherenit (1866) e radhit **Josip Stritar**-in (1836 – 1923), edukatorin e brezave të rinj poetikë, poetin, prozatorin, dramaturgun, eseistin, satirikun, shkrimtarin për fëmijë dhe redaktorin, në kulmin e fjalës së shkruar ndër bashkëkombësit e tij. Emri i tij lidhet me gazetatat dhe revistat e shumta të kohës, si redaktor dhe editor. Shkrimet e tija ia venë themelin teorisë dhe historisë së letërsisë sllovene, andaj gati mund të thuhet se roli i tij është më shumë të prodhojë poetë e shkrimtarë se poezi dhe prozë të vetën.

Atë që e propagandonte programi letrar i F. Levstikut e realizoi prozatori i parë i vërtetë slloven **Josip Jurčič** (1844-1881). Studimet e sllavistikës dhe gjuhëve klasike në Vjenë e pasurojnë intelektin e shkrimtarit, që jeton në varfëri të skajshme. Kjo varfëri, sipas biografëve të tij bëhet shkak i rrënimit të shëndetit. Prozën e parë (*Pripovedka o beli kači* /kači/ 44) të bazuar në tregimet popullore e boton më 1861. *Spomini na deda*⁴⁵ janë katër tregime (1863), sipas fjalëve të shënuara nga goja e gjyshit të tij. Tregimin më të mirë të tij e shkruan në Vjenë (*Hči* /Hči/ *mestnega sodnika*⁴⁶), ku përshkruan luftën e qytetarëve sllovenë kundër feudalëve gjermanë si dhe

dashurinë tragjike. Për romanin *Deseti brat* sipas motivit popullor, skicën e bëri si nxënës i klasës së tetë të gjimnazit dhe e botoi më 1866-67. Romani ka elemente realiste dhe romantike, ku hyjnë edhe ato autobiografike. Në romanin *Cvet in plod*⁴⁷ shihet qart ndikimi i kritikave të bëra nga Levstiku për romanin *Desti brat*. Jurçiçi aty përshkruan jetën e intelektualit në fshat. Koncepti i romanit është realist me ide romantike – idealiste. Me romanin *Doktor Zober* letërsia sllovene fillon rrugën e vet drejt letërsisë botërore. Është romani më i mirë i tij, ku personazhet, si ato pozitive, ashtu edhe negative janë të përshkruara në mënyrë tejet realiste.

Bukuria natyrore e vendlindjes (Vrsno pranë Kobaridit) që e përshkruan aq bukur me melodicitetin e gjuhës lokale në poezitë e veta, e radhit **Simon Gregorçiçi** (1844 -1906), krahas Presherenit, Levstikut dhe Jenkos ndër poetët më të adhuruar të kohës. Koha e veprimtarisë së tij është koha e vendosjes së themelit të jetës kulturore, politike dhe shoqërore sllovene. Si student i teologjisë, ai themelon lexonjtoren dhe korin rinor, duke ndikuar kështu në edukimin e popullatës. Për hir të poezive të tij, të botuara në shtypin e kohës, atë e quajnë “bilbili i Goricës” Përmbledhja e parë *Pesmi* (Poezi) (1882, në 1800 kopje) u shit për gjysmë viti. Më 1884 botoi përmbledhjen e zgjeruar të poezisë, e cila i inicioi kritikën e klerikëve dogmatikë (*Mahniç /Mahnič/* etj.), gjë që shpirtërisht e tendosi rëndë Gregorçiçin. Veçanërisht për faktin se grupi sulmues (klerikët, ku sipas thirrjes bënte pjesë edhe ai) nuk i ndante qëndrimet e tija lidhur me të ardhmen e kombit.

Grupin e ashtuquajtur të realizmit poetik e prezantojnë krijuesit, të cilët, secili në mënyrë të veçantë jep kontributin e vet letërsisë sllovene: **Fran Celestin** (filozof dhe teorik i letërsisë), **Fran Levec** (historian letrar dhe teorik i realizmit), e veçanërisht **Janko Kersnik** (1852 – 1897). Kersniku është poet, fejtunist⁴⁸, prozator, romancier. Përpos tregimit *Na Zherinjah /Žerinjah/* nuk botoi libër tjetër, por botimet i bëri vetëm në shtypin letrar të kohës. Më 1851 në Poljane pranë Shkofja Llokës u lind njëri nga shkrimtarët më të mirë sllovenë të shekullit të 19 – **Ivan Tavčar /Tavčar/**. Si doktor i drejtësisë, avokat i njohur u bë redaktor i *Lublanski Zvon*-it dhe i *Slovan*-it, nënkryetar dhe kryetar i qytetit të Lublanës (1911-1921). Letërsia e tij është e përshkuar me tema historike dhe aktualitete politike të kohës. Është mjeshtër i

prozës së shkurtër. Sipas konotacionit artistik është realist. Në shkrimet e veta përdor shpesh sarkazmin, veçanërisht në prozën satirike **4000** ⁴⁹ (1891). Pas botimit të ciklit me tregime **V Zali** (1894) bën një pauzë të gjatë, për tu paraqitur më 1905-1908 me romanin **Izza Kongresa**⁵⁰ dhe me krijimet tjera që merren si më të mirat të tij **Cvetje v jeseni**⁵¹ dhe **Visoshka /Visoška/ hronika**⁵².

Antipod i poezisë me ndjeshmëri tej mase dhe elegjiake të Stritarit dhe Gregorçicit na paraqitet lirika luftarake, ideore, patriotike e **Anton Ashkercit /Aškerc/** (1859-1912). Studion teologjinë, por fshehurazi lexon shumë edhe për religjionet tjera, veçanërisht për atë islame dhe për budizëm. Vetëdija mbi pabarazinë shoqërore, të cilën e fitoi që nga rinia e vet (si i varfër) si dhe udhëtimet e shumta, ndikuan shumë në krijimin e botëkuptimit të lirë të tij. Pas konfliktit me ipeshkvin e tij, e len detyrën e meshtarit dhe punësohet si arkivist në Lublanë.

Natyrizmi sloven as që ka përfaqësues të rëndësishëm. Kjo disi shpjegohet me prejardhjen e shumicës së shkrimtarëve të kohës (prejardhje fshatare – provinciale) si dhe me ndikimin e madh të kishës katolike në jetën e slovenëve. Sidoqoftë, **Zofka Kvedrova** (1878-1926) zë njërin nga vendet e merituara. Njihet si luftëtare për të drejtat dhe barazinë e gruas. Gjithashtu, këtu bëjnë pjesë edhe krijuesi i dramës moderne slovene **Etbin Kristan** (1867 – 1953), si dhe autori i shkrimeve të shumta humoristike **Fran Milčinski /Milčinski/** (1867- 1932).

Letërsia moderne slovene fillon me botimin e dy përmbledhjeve poetike më 1899: **Erotika** e Ivan Cankar-it dhe **Kozarec opojnosti** ⁵³ e Oton Zhupançit-it. Ajo zgjatë deri pas luftës së dytë botërore. Kjo letërsi mpleks në vete disa drejtime që janë paraqitur në letërsinë slovene: dekadencën, simbolizmin, neoromantizmin dhe impresionizmin. Krahas përfaqësuesve më eminent të modernes: Dragotin Kete-s, Ivan Cankar-it, Oton Zhupançit-it **/Župančič/** dhe Josip Murn- Aleksandrovit, në këto vite krijojnë edhe shkrimtarë dhe poetë të drejtimeve të ndryshme, që në letërsi quhen **bashkudhëtarët e modernes**.

Ritmin e lirë dhe shprehjen më të lehtë në letërsinë slovene e futi poeti i dalluar **Dragotin Kete** (1876-1899). Si poet kundërshton natyrizmin dhe dekadencën në poezi. Edhe pse në të shihet ndikimi i poezisë popullore, e veçanërisht poetikës preshereniane, forma e poezisë së tij është e lirë e sonetet kanë thellësinë e mendimit dhe ritmin e gjallë, e jo rrallë në to ka edhe misticizëm.

Poetin e bukurisë natyrore dhe të krejt asaj që shpreh dashuria ndaj kombit dhe jetës, **Josip Murn – Aleksandrovin** (1879-1901), nuk e përkëdheli aspak jeta. U rrit pa prindër. Vitet e shkollimit i kaloi nëpër internate. Bashkë me Kete-n, Cankar-in dhe Zhupançiç-in ishte anëtar i shoqatës së nxënësve "*Zadruga*"⁵⁴. Pas Vjenës e Pragës, ku tenton të studiojë kthehet i sëmurë me TBC në Lublanë, ku së shpejti vdes.

Njeriu që e përcaktoi epokën e vet si poet, shkrimtar, romancier, dramaturg, përkthyes, politikan, kritik letrar, satirik, eseist, reformator dhe revolucionar social **Ivan Cankar** (1876-1918), jo vetëm se i hetoi, por edhe i qiti "në letër" të gjitha kundërthëniet shoqërore me një mjeshtri të rrallë. Me veprën poetike "*Erotika*" (1899) zgjoi mllefin e qarqeve moraliste kishtare me në krye ipeshkvin e Lublanës Jegličin /*Jeglič*/, i cili i bleu 700 prej 1000 kopjeve dhe i dogj. I vetëdijshëm se në poezi nuk mund të krahasohet me miqtë e tij të modernes Zhupançiçin dhe Keten, ai vazhdon në prozë, megjithëse në lirikën e tij ka shenja të autentike njohëse. Skicat e Cankarit, të përshkuara me një realizëm bindës fillon t'i botoi shumë heret në revistat *Slovenec*, *Slovenski narod* dhe *Ljubljanski zvon*⁵⁵. Zhgënjimet në realitetin slloven i përshkruan në romanin *Na klancu*, ku hasen edhe shënime autobiografike. *Hlapec Jernej in vjegova piavica*⁵⁶ është vepra më e mirë e tij. Sidoqoftë, vendin më të merituar autori e zë me dramën e tij *Za narodov blagor*⁵⁷, *Jakob Ruda*, *Kralj na Betajnovi*, *Pohujshanje* /*Pohujšanje*/ *v dolini shentflorijanski* /*šentflorijanski*/ ⁵⁸, *Hlapci*⁵⁹

"O atdhe, ai të do tani, / i duhet të të duaj me mllef të nxirë në shpirt" janë vargjet e modernistit slloven nga grupi i të katërve – **Oton Zhupançiç** (1878-1949)⁶⁰.

Përfaqësuesit më të denjë të *bashkudhëtarëve e modernes* sllovene: **Ksaver Meshko** /*Meško*/ (1874-1964), qëndrimet idealiste e të cilit e largojnë nga ajo që kishte nevojë populli i tij, **Fran Saleshki Finzhgar** /*Saleški Finžgar*/ (1871-1962), piktori i jetës së fshatit dhe provincës, **Lojz Krajger** (1877-1959), në veprat e veta natyraliste përshkruan pa zbulime jetën dhe rrethanat në Slloveni para dhe pas Luftës së Parë Botërore dhe **Vladimir Levstik** (1886-1957), në veprat e para shkruan me stil të lartë e më vonë mbizotëron toni satirik.

Si shprehje e shkatërrimit shoqëror dhe shpirtëror të klasës qytetare në mes të dy luftërave dhe si kundërpeshë e impresionizmit, në Evropë u paraqit ekspresionizmi si rrymë në art, pra edhe si rrymë letrare. Në Itali ndërkohë paraqitet futurizmi, që pastaj merr hov në Francë, Rusi,

në Angli, kurse shkrimtarët e Amerikës më shumë anonin kah natyralizmi.

Me Revolucionin e Tetorit, gjegjësisht me përpunimin artistik të tij lind realizmi socialist, që do të ndikojë në letërsinë sllovene, edhe përkundër censurës së ashpër të regjimit policor. Gjatë kësaj periudhe letërsia më së shumti përcillet nga revistat letrare si: **Ljubljanski zvon** (deri 1941), **Dom in svet**⁶¹ (deri 1944), **Trije labodji**⁶² (1922, redaktor Ivan Vidmar), **Krizh na gori /Križ na gori/**⁶³ (1924-1927, redaktorë: Edvard Kocbek, Anton Vodnik, Bozho Vodusek /Božo Vodušek/), **Krizh /Križ/**⁶⁴ (1928-1930, Kocbek), **Mladina**⁶⁵ (1924 – 1928 Bratko Kreft, Vinko Koshak /Košak/, Alfons Gspan), **Sodobnost**⁶⁶ (1933 –1941 F. Kozak, J. Vidmar, S. Leben), **Kritika** (1925-1926, J. Vidmar) si dhe **Dejanje**⁶⁷ (1938 –1941, E. Kocbek, F. Vodnik).

Tri janë gjeneratat e krijuesve letrarë në mes të dy luftërave:

- a. *Gjenerata në kalim* (në mes të modernes dhe realizmit socialist)
- b. *Gjenerata e ekspresionistëve dhe poetëve socialë dhe*
- c. *Gjenerata e realistëve socialë e krahas saj gjenerata e ekspresionistëve të vonshëm*

a. **Alojz Gradnik** (1882-1968) në vargjet e tij fillimisht ndihet ndikimi i Jenkos, Gregorçicit dhe Murnit e më vonë krijon shprehjen autentike në poezi. Bazë për botëkuptimin e tij u bë pesimizmi i Shopenhauerit, gjë të cilën e ushqen edhe rrethi i vrazhdë në të cilin jeton. Dashuria me ëndrra shpesh të pa realizuara bëhet nxitje për shpirtin e tij krijues.

Në fillim poeti narcisoid, **Igo Gruden** (1893-1948) zhvillohet më vonë në poetin e Primorskës⁶⁸ së robëruar, përshkruan përjetimet në burgje dhe llogore, egërsinë e luftës, por edhe besimin në të ardhmen e mirë.

Në prozë, prej kësaj gjenerate dallohen: **Ivan Pregel /Pregelj/** (1883 – 1960, poet, përkthyes, kritik letrar dhe eseist). Në prozën e vet i pari ndër sllovenët e fut meditimin, kurse rrëfimin e ngërthen me citate latine duke tentuar ta “kopjojë” stilin biblik. Edhe pse stili i tij kryekëput i takon barokut, proza e tij ka elemente realiste, natyraliste, romantike dhe ekspresioniste. Pas vdekjes së Cankarit, më se një decenie e mban primatin ndër prozatorët sllovenë. Është përkrahës i moralizmit katolik në letërsi; **France Bevk** (1890 -1970) ndër prozatorët më produktivë sllovenë. Imagjinata e tij e zhvilluar e

shtyn të provohet në poezi, prozë, përkthime, tregime për fëmijë, romane, drama, tregime dhe romane historike në fillim duke u mbështetur në Cankarin dhe shkrimtarët rusë, por më vonë më shumë përdorë realizmin, si metodë të rrëfimit. Vepra e tij artistikisht më e përsosura është romani **Kapelan Martin Čedermac /Čedermac/**. Romani përshkruan jetën e meshtarit slloven nga Beneshka Sllovenija /*Beneška Slovenija*/ ⁶⁹ kombëtarisht të vetëdijshëm gjatë okupacionit fashistë; **Jush Kozak/Juš/** (1892-1964) veprat e tij letrare zbulojnë shkrimtarin origjinal të prozës, të cilin më shumë e karakterizojnë mendimet filozofike dhe kritika shoqërore se sa krijimi i fotografisë dhe personazheve epike të njerëzve, është pra, më shumë mendimtar se narrator.

b. Poetët e lindur në fillim të shekullit 20, të cilët shprehjen artistike e gjetën në ekspresionizëm ndahen në tri grupe: a) *përfaqësuesit e lirikës sociale ekspresioniste*, b) *lirikës religjioze ekspresioniste* dhe c) *lirikës kozmike*.

- **Tone Selishkar /Seliškar/** (1900-1969) – poeti i parë proletar u paraqit ndër sllovenët në mes të dy luftërave. Fryma e shkrimeve të tij përfshinte besimin e pathyeshëm në fuqinë e popullit dhe në të drejtën. Në fillim poezinë e ka ekspresioniste, më vonë kalon në prozën e thjeshtë poetike, e në fund përdor formën e sonetit. Është i njohur edhe si shkrimtar për fëmijë.

- **Srečko Kosovell /Srečko Kosovel/** ⁷⁰ (1904 –1926), - poet i përjetimeve të singerta, i fuqisë dhe i besimit të madh në kohën që vjen.

- **Mile Klopčič /Klopčič/** (1905 –1984) krahas Selishkarit poeti më eminent social ndër sllovenët. Është edhe përkthyes i dalluar.

- *Lirikën religjioze ekspresioniste* më së miri e përfaqëson **Anton Vodnik** (1901 -1965), kurse **Edvard Kocbek** (1904-1981) ⁷¹ realitetin shoqëror e paraqet me stil të lirë dhe me figura të fshehta poetike. **Bozho Vodushëk /Božo Vodušek/** (1905-1978) ⁷² i takon gjeneratës së poetëve të katolikëve të rinj. **Millan Jarc** (1900 –1942), në poezinë e ti ngërthehet romantika dhe mendimi i prerë, përvojat momentale dhe vëgimet e paqarta, mistika dhe realiteti. Është përfaqësues i *lirikës ekspresioniste kozmike*.

c. Letrarët që i takojnë drejtimit të **realizmi socialist** në letërsinë sllovene paraqiten viteve të dyzeta të shekullit të kaluar, kryesisht nga pjesët periferike të Sllovenisë: nga Prekmurja (Mishko Kranjec), nga

Koroshka /Koroška/ (Prezhihov Voranc), nga Lugina e Ptujit (Anton Ingoliç, Ivan Potrç), nga Primorska (Ciril Kosmaç).

- **Prezhihov Voranc** /Prežihov/ me emrin e vërtetë Lovro Kuhar (1893 – 1950) paraqitet shumë heret në skenën letrare, por me romanin *Doberdob* dhe me *Samorastniki*⁷³ imponohet si prozaist, piktor i realitetit të klasës punëtore në rrjedhat kombëtare të kohës. Vepra e fundit *Solzice*⁷⁴ merret si njëra ndër veprat më të mira të letërsisë së deriatëhershme sllovene.

- **Mishko Kranjec** /Miško/ (1908-1983), shkrimtari “i trevës larg botës -Prekmurjes⁷⁵”, që jeton në mënyrë tradicionale, e që skamja shpesh i drejton të marrin rrugët e botës e përshkruan atë jetë që rrjedh vetvetiu, pa turbulenca, por me ndjenjë të natyralizmit. Është romancier, novelist, shkrimtar për fëmijë, shkrimtar i dramës...

- **Ciril Kosmaç** /Kosmač/ (1910 -1980) me aktivitetin e tij revolucionar antifashist krijon bazamentin e veprës letrare. Në veprat e tij përshkruan jetën e popullit gjatë okupimit fashist me një mjeshtri të thellimit psikologjik në personazhet e veta. Pas Luftës së Dytë Botërore punon si redaktor i *Slovenski poročevalec*⁷⁶, *Tovarish*⁷⁷ dhe si dramaturg i *Triglav-filmit*.

- Krahina e Ptujit i jep dy krijues të prozës me tematikë të realizmit socialist **Anton Ingoliç** /Ingolič/ (1907- 1992), që ka tematikë të vet jetën e vështirë të zejtarëve të vegjël, dhe **Ivan Potrç** /Potrč/ (1913 -1993) me përshkrimet e bukura të jetës së vështirë të fshatarëve të tij. Potrçi i ka dhënë kontribut të çmueshëm edhe dramatikës sllovene.

Sa i përket letërsisë së diasporës sllovene duhet përmendur **Lui Adamiçin** /Adamič/ (1898-1951), që me idetë përparimtare, revolucionare për kohën u bë halë në sy forcave retrograde, që edhe bënë atentat në të. Gjithashtu vend të rëndësishëm zë edhe poeti **Ivan Zorman** (1899 –1958).

Pas Ivan Cankarit, vetëm **Bratko Krefti** (1905 -) pati mundësi ta përvetësojë publikun me dramën e tij. Me romanin e tij të parë na paraqet zhvillimin e tij ideor, që nga adhuresi i ideve të Tolstojit, e deri sa bëhet marksist. Në krijimtarinë dramatike tematikën e merr që nga iluministët sllovenë, deri në shoqërinë borgjeze në fillim të Luftës së Parë Botërore. Është autor i tragjedisë së parë sllovene *Tugomera*. Merret edhe me zgjedhjen e shumë çështjeve teorike dhe praktike të artit teatror.

Me krijimin e Universitetit të Lublanës dhe të Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve u jepën baza shkencore para së gjithash historisë dhe teorisë së letërsisë. Gjithashtu shkencëtarët sllovenë thellohen në studimin e historisë së gjuhës sllovene me dialektet e saj. Kontribut të paçmueshëm këtu dhanë: Stanisllav Shkrabec /*Stanislav Škrabec*/, Rajko Nahtigall⁷⁸, Fran Ramovsh /*Ramovš*/ dhe Anton Breznik.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, realizmi socialist shumë shpejtë filloi të humbasë tokën nën këmbë. Shpirti i krijuesve letrarë sllovenë ndër të parët në bllokun socialist e akceptuan zhgënjimin mbi botën e barazisë për të gjithë. Edhe pse nuk kishte thyerje si në republikat tjera të ish Jugosllavisë, politika komuniste sllovene - jugosllave inskenoi procesin për diferencimin e më të “rrezikshmëve” të njohur si “*Dahauski /Dachauski/ procesi*”⁷⁹, për të cilin humoristi i njohur **Igor Torkar** e shkruan romanin-akuzë (me të njëjtin titull) kundër bashkëkombësve të vet që mbanin pushtetin fill pas çlirimit. Ky proces duhej të ishte njëfarë pandami për Goli Otokun. Edhe botimi i romanit *Strah in Pogum*⁸⁰ u bë “kilan” në lirinë e mendimit të shprehur. Viti 1968 dhe lëvizja studentore në tërë Evropën la gjurmën më të thellë pikërisht në rininë studentore sllovene, një ndër udhëheqësit e së cilës ishte **Jasha Zlobec /Jaša Zlobec**/, kurse “pastrimi” që u bë në Universitet, duke suspenduar profesorët e rinj më progresiv, me në krye filozofin **Tine Hribar**, ishin simptome se dora e hekurt komuniste dëshironte të ventë çdo gjë nën dirigjimin e vet. Pranvera sllovene e viteve të tetëdhjeta ishte fillimi i fundit të sundimit diktatorial, edhe pse, shikuar nga pjesët tjera të shtetit të përbashkët dukej si demokraci e tepruar. Grupi i intelektualëve më përparimtarë u bashkuan rreth revistës **Nova Revija**, që u bë manifest i mendimit të lirë për tërë lindjen komuniste. Programi nacional slloven i botuar në numrin 57 të kësaj reviste u realizua disa vjet më vonë, më 1991, kur Sllovenia shpalli pavarësinë.

¹ vetëm 5 vjet para Mesharit të Buzukut

² “Fama e Vojvodinës sllovene”. Termi *Kranjska* përdoret në këtë kohë për termin e sotëm gjeografik Sllovenia qendrore

³ Anton Berishaj, Retorika dhe letrarësia – Teksti i Bogdanit

⁴ Krahina Ilire

- 5 vitet e fundit të jetës së tij e mësoi shqipen
- 6 Stanko Janezh (Janež), Zgodovina slovenske književnosti
- 7 Revolucioni borgjez shpërtheu jo vetëm në Francë, por edhe në Gjermani, Austri, Hungari, Itali e gjetiu
- 8 Shoqatë kulturore-politike
- 9 Ky studiues me të drejtë zë vend të rëndësishëm edhe në studimet shqiptare me veprën e tij "Die slavischen Elemente im albanischen" (Vjenë, 1870), në të cilën jep edhe pasqyrën e vendbanimeve shqiptare si dhe të dhëna statistikore mbi popullsinë. Aty gjithashtu jep edhe bibliografinë e dokumenteve dhe librave të botuar shqip, gjithsejtë 37 që i njeh ai. Burimi: Enciklopedia Slovenije I, Albansko-slovenski odnosi, N(ikollë) B(erishaj), 39-41
- 10 Është slloven, por që jeton dhe vepron gjatë kohë në Zagreb. Në vitet 1833-34 përpos përkthimeve që u bënë autorëve antikë dhe modernë spanjollë, serbë, polakë, ukrainas, ai përkthen edhe disa këngë popullore shqiptare. Burimi: A. Slodnjak, O Stanku Vrazu kot slovenskem pesniku, Slav. Revija 1950, 65-90
- 11 më 1859 absolutizmi i Bahut përfundon si shkak i disfatës së ushtrisë austriake nga italianët. Austria sipas kushtetutës së re, të njohur si "Diploma e tetorit" duhet të organizohej si shtet federativ, gjë të cilën e përkrahën udhëheqësit konservativë të kombit slloven.
- 12 "Doba čitalnic"
- 13 Shoqëria dramatike, shoqëri për zhvillimin e artit dramatik
- 14 Staroslovenci dhe Mladoslavenci
- 15 "Përpara"
- 16 "Populli slloven"
- 17 Burimi: Stanko Janezh, vepra e cituar. Për shkak të numrit të madh të tyre, këtu do t'i shënojmë në mënyrë taksative, pa hyrë thellë në përmbajtje
- 18 "Kmetijske in rokodelske novice", shkurt Novice - Risitë bujqësore e zejtare, Risitë
- 19 "Shoqëria bujqësore"
- 20 shoqata sllovene
- 21 "Ylli i dritës"
- 22 "Zërat nga Austria e brendshme" Celovec - Klagenfurt
- 23 "Thumbi"
- 24 "Slloveni klerikal"

- 25 “Uniteti”. Në kuadër të kësaj gazete del një artikull interesant udhëpërshkrues për shqiptarët. Niko Ninič, në kuadër të Kujtimeve të veta mbi Ballkanin e boton udhëpërshkrimin “Albanija in Albanci” (Shqipëria dhe shqiptarët), të cilin, për shkak të interesimit të madh të lexuesve e boton si broshurë në vete, në Trieste, më 1910.
- 26 “Dituria”
- 27 “Ushtrime”
- 28 “Kurora”
- 29 “Bleta sllovene”
- 30 “Lajmëtari i shkrimit slloven”
- 31 “Shoqëria e Mohorit- Shoqëria e shën Mohorit”
- 32 “Lajmëtari slloven”
- 33 “Gojëtar”
- 34 “Lule nga livadhet tona dhe të huaja” dolën 22 numra
- 35 “Vëllai i dhjetë”
- 36 Vjetarët
- 37 “Kallinjte”
- 38 “Kambana”
- 39 “Kambana e Lublanës”
- 40 “E premtja e Madhe”
- 41 Skica nga jeta dhe veprimtaria e shkencëtarit Shnakshneperlajn
- 42 Në shtëpinë e axhës
- 43 Lulja e vrrarë
- 44 Tregimi mbi gjarpërin e bardhë
- 45 Kujtimet për gjyshin
- 46 E bija e gjykatësit të qytetit
- 47 Lulja dhe fryti
- 48 Fejtonisti i parë slloven
- 49 Si do të dukej Lublana në vitin 4000 nëse do të pranonte qëndrimet e mbrapshta të disa bashkëkohësve të tij
- 50 Në prapaskenë të Kongresit
- 51 Lulet në vjeshtë
- 52 Kronika e Visokos – roman i papërfunduar historik mbi jetën e dy familjeve në fshatin Visoko.
- 53 “Gota e dehjes”
- 54 “Kooperativa”
- 55 Në skicat e Cankarit përngjajnë pa masë skicat e shkrimtarit tonë Migjenit, edhe pse Migjeni, sipas të gjitha njohurive mbi të, nuk e

njinte gjuhën e autorit dhe se ato nuk ishin të përkthyer në gjuhët që i njihnte Migjeni.

56 “Shërbëtori Jernej dhe e drejta e tij” – tregim sipas ngjarjes reale të një njeriu nga provinca, fillimisht materialin e përdori si material propagandues gjatë fushatës zgjedhore për deputet

57 “Për mirëqenien e popullit”

58 “Skandali në fushën e Shën Florianit”

59 “shërbëtorët”

60 Më shumë për të në biografinë e tij në libër

61 “Shtëpia dhe bota”

62 “Tri mjellmat”

63 “Kryqi në mal” – fletushkë e lëvizjes së katolikëve të rinj

64 “Kryqi”

65 “Rinia”

66 “Bashkëkohësia”

67 “Veprimi” – me themelimin e kësaj reviste u bë hap i rëndësishëm në jetën kulturore dhe shoqërore, që në fillim të LNÇ-së rezultoi me bashkimin e të gjitha forcave përparimtare dhe atdhedashëse në Frontin Çlirimtar të kombit slloven (Osvobodilna Fronta slovenskega naroda)

68 Pjesa bregdetare e Sllovenisë

69 Sllovenia Vendedikase

70 Shënimet për të në kuadër të librit

71 Shënimet për të në kuadër të librit

72 Shënimet për të në kuadër të librit

73 “Jetimët” (1940 me hyrjen e Josip Vidmarit)

74 “Lulet e Shën Gjergjit”

75 Krahina sllovene përtej lumit Mura, shënim i tij

76 “Lajmëtari slloven”

77 “Shoku”

78 Rektori i parë i Universitetit të Lublanës. Është njohës dhe studiues aq i mirë i gjuhës shqipe, sa që me punimet e veta shkencore jep kontribut të madh për elbasanishten si bazë të gjuhës letrare shqipe. Në Arhiv za arbanashku starinu, jezik i etnologiju (revistë që botohet në Beograd viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar) hasim punimin e tij “O elbasanskem pisku in pisemstvu na njem”. Ka bashkëpunim të ngushtë me Gjergj Pekmezin, të cilit i ndihmon edhe ta botojë

Gramatikën e gjuhës shqipe, Vjen 1908, burimi "Miklošič je vedel, Nahtigal tudi, pa mi?", Naši razglasi, Nikollë Berishaj
 79 "Procesi i Dahaut", proces i njohur në historinë e re sllovene, ku intelektualët më të fortë (që përjetuan kampin famëkeq fashist) akuzohen si bashkëpunëtorë të fashizmit.
 80 "Frika dhe guximi" roman i Edvard Kocbekut

Përrim

ZEQIRJA BALLATA

POEZI

të përzgjedhura nga:

zeqirja ballata
dhe
jaumin mamuti

ZEQIRJA BALLATA:

Akrostik

Gugatjet s`t`i ndërprejnë hapërimet universale:
Ah! Medet! Nyja gordiane, muzat bulëzuese
Zunë që n'ag t'na ndjekin këmba-këmbës.
Magjës së rollit i dole zot
Eh! Kurrë të mbushur.
Ngarende ngultas
Drejt Trapit.

Zëri s't'u shua.
As drita vezulluese
Jo, mbeten për t'u fytafytur
Me Nyjen keq t'lidhur nga Tejprapshti.
Ih! Kur më do të zbardhë ajo Ditë e lume?

Maribor, '95

Përrurim

Zeqirja Ballata:

PRO M Eu! jote kremte e kohëpakohë,
(Sipas Fo) ndjellazezet Qyqe seç përbluajnë mbrapshtinë,
gjatë Tejprapshtët po hedhin llapërçinë,
është' Evropa therpelë q'ua dridhë vithet
llomshtive ardhaçake të Tejkarpevet.

Përgëzonj Barrën, por, s'mund t'ua lënë Këlyshëve
Premën endacakë posht' e përpjetë për t'lodruar
Përgëzonj ravgimeve tona t'travajshme,
Un' përgëzonj i Arbërit peng bese jemi a s'jemi o i Uruar
Përgëzonj sharkit' e frengjive stërgjyshore do ta bëjnë tevona Pjellën,
Premën atë t'amamshmen Kremte tënde dhe tonën.

Përgëzonj Shqip

Un' Pal Engjelli

1402.

Maribor, 1994

Shënim: Ky tekst (i inspiruar nga Formula e pagëzimit e Përgëzimit të tekstit i botuar i parë i gjetur) është botuar në gazetën "Alternativa" më 1987, kur dhe është ekzekutuar vepra vokale/instumentale nga një grup i njohur i këngëtarëve dhe instrumentalistëve. Ky tekst është përdorur nga një grup i njohur i këngëtarëve dhe instrumentalistëve për recitator, bariton, kor dhe ansambel. Ky tekst është përdorur nga një grup i njohur i këngëtarëve dhe instrumentalistëve për recitator, bariton, kor dhe ansambel.

Riatdhesimi

U kthye intelektualisht
sado jo fizikisht
n'vatër univerzi
n'Bibliotek' kombëtare
tek trurin ushqen
djalëria shqiptare
që aq shumë e deshi
n'shkrime e ngjeshi.

Dhe - u kthye
kombiari
këtu tek e ka vendin
dhe ku deshi
ky intelektual e njeri
Krist' Maloki.

shkurt 07

Vrn'l se je intelektualno
čepav ne fizično
na ognjišču univerzuma
v Knjižnici - nacionalni
kjer mozek hranijo
mladi Albanci
ki jih je tako rad imel
in jih - v spisih zajel.

In vrnil se je
- ozaveščeni
kje' mesto mu je
prav tam želel je
intelektual'c človeški
Krist' Maloki

Tri poezi

Zeqirja Ballata:

PRO MEMORIA 1462
(Sipas Formulës së pagëzimit)

...
Un' ...
Përgëzonj...
P'r emënit Atit e t'Birit
Përgëzonj p'r emënit Atit e t'Birit e t'Trimit
Un' përgëzonj p'r emënit Atit e t'Birit e t'Trimit t'Arbënit
Përgëzonj p'r emënit Atit e t'Birit e t'Trimit
P'r emënit Atit e t'Birit
Përgëzonj Shqip
Un' Pal Engjëlli
1462.

Prishtinë, 1987

Shënim: Ky tekst (i inspiruar nga Formula e pagëzimit e Pal Engjëllit, si tekst i botuar i parë i gjetur) është botuar në gazetën »Rilindja« më 1987, kur dhe është ekzekutuar vepra vokalo-instrumentale me të njëjtin titull për recitator, bariton, kor dhe ansambël orkestral. Pas ekzekutimit janë bërë dhe vlerësime/kritikë...

Shënim: Kjo këngë solo me piano, e kompozuar (1990) po në 80-vjetorin e Nënës Terezë, është kënduar shumë herë nga këngëtare shqiptare e sllovene (të shoqëruara nga autori) në koncerte e festivale në Kosovë, Kroaci, Shqipëri, Slloveni, si dhe janë bërë vlerësime të shumta.

Gani Spahiu:

Nënë Tereze bijë Shqiptare

Nënë tereze bijë Shqiptare, zemërbardhë zemërbujare
Kudo që dielli lëshon rreze, është mirësi e Nënës Tereze

Nënë Tereze bijë Shqiptare, zemërbardhë, zemërbujare

Fjalëmbël, shpirtndritur, për gjithë njerëzit e sfilitur
Dorëshpëtim për të varfër, t'pastrehuar, t'pavatër

Nënë Tereze, Nënë Tereze, zemërbardhë që lëshon rreze
Zemërngrohtë, zemërnur, për të mjerë, të sëmur

Nënë Tereze t'i don bota, veprat tua, fjalët e ngrohta

Nënë tereze, nëna jonë, të rroft emri përgjithëmonë
Të rroftë emri deri n'amshim, bijë e shtrenjtë e popullit tim.

Shënim: Mbi këtë poezi, është kompozuar kënga korale me të njëjtin titull për recituese dhe kor pionierësh ose femrash, e porositur nga ShKK dhe e realizuar (krahas këngëve të kompozitorëve tanë të tjerë) në koncertin enkas më 1990, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Nënës Terezë, për të cilin (koncert) ka dhe vlerësim kritik.

Liri Loshi:

Nëna Terezë

Një copë bukë në dorë
Mori botën në sy
Kjo tokë e ka lindur
Si mua si ty

Bukën e kësaj toke
E ndanë në njëmijë pjesë
Siç ndan rrezet dielli
Mbi lulet plot vesë

Bota n'gojëjë të ujkut
Në gjumë ariu
Në skenë Nëna Terezë
Gonxhe Bojaxhiu

S'ma bën të njohur Tokën
Vetëm fjala Besë
Mbi botë tok me qiellin
Nxën Nëna Terezë

Ajo nuk është
Veç e këtij nënqielli
Është e të gjithëve
Siç është dhe dielli.

Shënim: Kjo këngë solo me piano, e kompozuar (1990) po në 80-vjetorin e Nënës Terezë, është kënduar shumë herë nga këngëtare shqiptare e sllovene (të shoqëruara nga autori) në koncerte e festivale në Kosovë, Kroaci, Shqipëri, Slloveni, si dhe janë bërë vlerësime të shumëta.

Zeqirja Ballata:

Kompozuesi

Bot' individuale n'peshoj' trolli
I mbrumur jo me rastësi
Punën e bën si luftën Perolli
S'i duhen programe e parti
Mjaftojn' ballafaqime si Mic Sokoli.
Gaton dashuri gëzim dhimbsuri
Si Nënë Tereza - Gonxhe Bojaxhi
Notash pa prokurori e donatorë
Vargun si poeti me ndjesi t'stërhollë
E Shqiptari që pret mikun n'shtëpi.

Me t'ndryshme ritme e metrume
Ë' bosht i të lashtave këng'evalle
Që i stolisë jonet jo pa Lulelajle
I bën ballë të stuhishmeve mote
Indiferencës kok'tule dizakorde.

S'ka kohë si të vdes
I zënë me të buk'rin ves
Vetëm po jo i vetmuar
Andante-Allegro në veti
I ndi'shëm pendël Shpen'deti.

Me botë pentagramesh n'sirtar
Dhe jonet jo pa dhimbje e lot
Pa çka se mbesin n't'ngratën gjeferdar'
Pret të tyren çast n'këto kohë travaje
T'iu vijë Pëllum'përjetësimi se s'kanë çare.

Lavdi Nënës Terezë

Pikëllim ditëzezë

E premtë – pesë shtator – nëntëdhjeteshtatë

Për t' papërlyeren e shenjtë gjithënjërzore

Nënë Terezë alias Gonxhe Bojaxhiu Shqiptare

Misionare e t'sëmurëve pleqë fëmijë bonjakë

T'vetëm pashpresë

Lavdi!

T'bekuares Nënë

Uratë gjithmonë

- oj jetë e jetëve

Amen.

Mater Theresia

Dies ater - et luctus

Veneris die - quinto Septembris nonaginta septem

Pro immaculata, sacra, humana

Matre Theresia alias Gonxhe Bojagjiu - Albanica

Pro missionaria miserorum, liberorum, senum, aegrorum

Gloria Matri benedictae

Pro vita eius

Aeterna oramus

A m e n

Maribor, shtator '97

Jaumin Mamuti

ngadal ngadal

më vjen nën dritare
si erëza e qershisë në divanin tim
ma rrëmbeve lehtë gjumin me rrezet e hënës
që përcollën turmatë e puthjeve të buta....

fluturo.... dhe vrapo në shpatullat e mia
që më mbajnë lartë këngën e ninullave
të gatuar nga dashuria...

bukën e nxehtë në tryzën time
e futa thellë nën pallton time
... lakminë që ma fale
duke e prekur në kopshtin e buzëve të tua

... në ngushticën e largimit tim
... të ditëve grabitqare ... nga unë
... prej meje
... ashtu i ulur mbi mendimet bashk me karrigën time

Lubanë, diku pas mjesnate

Jaumin Mamuti

Lakuriq në bregdet

Si shkëmbijtë në pritje të
dallgëve,
... të kapur me duar të thata,
... nica e ëndrrave të
rrembyera nga era
shpalonte gjurmët e algëve

të shtrira në murin e
argjendtë
.... peshkatari i humbur
gjurmonte çerdhen e zogjëve
... që kishte humbur me
gjethe të lagura nga rrënja e
bishave të natës ...


E ne të dy.... kishim humbë
mengjezin duke e prit atë në
mesnatë!

Slloveni, 2008

ALTERNATIVA A

NARODNA IN UNIVERZITETNA KNJIŽNICA

403 668₂₀₀₈



920083885,4

COBISS ©



ALTERNATIVA ALTERNATIVA